


**RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Për Programin e studimit BSc në “Psikologji këshillimi dhe pedagogji”**

**Ofruar nga Kolegji Universitar “Bedër”**

**Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:**

- 1. Dr Marjana Çadri**
- 2. Dr Silvana Loka**



(Mars/2019)

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Për Programin e studimit BSc në “Psikologji këshillimi dhe pedagogji”

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar “Bedër”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti Filologjisë dhe Edukimit
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Licensuar me nr 330, datë 07.08.2012
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Akredituar me UMASH nr 223, datë 04.06.2013
5	Titulli i programit të studimit:	BSc në “Psikologji këshillimi dhe pedagogji”
6	Cikli i studimit:	Cikli I parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha anglisht
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6 (gjashtë)
16	Numri i studentëve	38 studentë

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim



## HYRJE

### Të dhëna për programin e studimit Bachelor në “Psikologji këshillimi dhe pedagogji”

Programi i studimeve Bachelor në “Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji” është hartuar në përputhje me “Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” Nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar. Programi është licensuar me Urdhër të MASH Nr 330, datë 07.08.2012 “Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë “Bachelor” dhe “Master i Shkencave” në Shkollën e Lartë Universitare jopublike “Hëna e Plotë” (Bedër). Ky program studimi i është nënshtruar akreditimit të tij 1 (një) vit pasi është licensuar, konkretisht programi është akredituar me Urdhër të MASH nr 223, datë 04.06.2013, mbështetur në VKA nr 469, datë 03.05.2013. Në vitin akademik 2012-2013, vit në përfundim të të cilit ka ndodhur edhe procesi i akreditimit të parë të programit, nuk ka patur studentë të regjistruar në këtë program studimi. Ky përfundim del (në mungesë të të dhënave të drejtpërdrejta lidhur me regjistrimin e studentëve në vitin e parë në këtë vit akademik) duke iu referuar mungesës së të diplomuarve në vitin akademik 2015-2016, vit në të cilin do të duhet të diplomoheshin studentët, nëse do të kishte regjistrime në vitin akademik 2012-2013. Nga të dhënat e Raportit të vlerësimit të Brendshëm (RVB) rezulton se në vitin akademi 2013-2014 janë regjistruar për herë të parë 30 studentë.

Programi studimit Bachelor në “Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji”, i cili ofrohet nga Departamenti i Shkencave të Edukimit, në Fakultetin e Filologjisë dhe Edukimit, është me kohë të plotë, me 180 kredite, me kohëzgjatje 3 vite akademike, në gjuhën angleze. Ofrimi në gjuhën angleze ka kërkuar zotërimin e kësaj gjuhë në momentin e regjistrimit të studentëve dhe është një ndër kriteret përzgjedhëse. Për studentët që nuk kanë njohuri të mira të gjuhës angleze, vetë Institucione përgatiste kurse paraprake në ofrimin e kësaj gjuhe. Nga vizita e kryer në Institucion dhe konkretisht nga takimi me Dekanen e Fakultetit, GVJ iu komunikua se Dosja që është dërguar në MASR për riorganizim të këtij programi ka parashikuar që programi të ofrohet në gjuhën shqipe, pasi ka mangësi në njohuritë e gjuhës angleze nga kontigjenti për student në këtë program.

Në programin Bachelor në “Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji” ndjekin studimet 38 studentë gjithsej, përkatësisht: 17 studentë në vitin e parë; 14 në vitin e dytë dhe 7 studentë në vitin e tretë.

Intitucioni na bëri me dije se programi i paraqitur për riakreditim është dërguar për riorganizim në MASR me shkresën nr.99/1 prot. datë 29.09.2017, me synimin që të plotësoheshin 6 (gjashtë) rekomandimet e marra në Akreditimin e parë. Kjo kërkesë ka përfshirë riorganizim e gjashtë programeve për të cilat kërkohet riorganizimi në MASR. Ndërkohë, programi i studimit “Bachelor në Psikologji këshillimi dhe pedagogji” nuk është riorganizuar në zbatim të VKM nr. 41, 41.01.2018 dhe, sipas RVB dhe të gjitha takimeve të organizuara gjatë vizitës në institucion, nuk ka filluar asnjë praktikë për këtë riorganizim me MASR.

Programi i mësipërm, në tërësinë e programeve bashkëkohore në fushën e shkencave të edukimit, konsiston në një studim të kombinuar të teorive dhe praktikave të sotme në fushën e psikologjisë dhe pedagogjisë me synimin që studentët në përfundim të studimeve Bachelor të zotërojnë njohuritë e nevojshme teoriko profesionale në këto fusha.

Vlerësojmë se jemi në kushtet në të cilat ka ndryshuar konteksti i zhvillimeve të profesionit të psikologut nga periudha në të cilën programi është licensuar dhe akredituar për herë të parë. Në kohën në të cilën është bërë kërkesa për riorganizimin e programit, me shkresën nr.99/1 prot. datë 29.09.2017 (me synimin që të plotësoheshin 6 (gjashtë) rekomandimet e marra në Akreditimin e parë) si dhe më vonë, në kohën në të cilën është bërë kërkesa “për akreditimin periodik të programit të studimit”, nr. 56 prot, datë 29.05.2018, drejtuar Drejtorisë të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Kolegji Universitar Bedër nuk ka marrë parasysh përcaktimet ligjore të profesionit të psikologut, që përcaktojnë kriteret e licensimit të psikologut sipas ligjit “Për urdhrin e psikologut në republikën e Shqipërisë”, Nr. 40/2016, sipas të cilit, në Nenin nr. 7 “Kriteret e anëtarësisë” përcaktohet se anëtar i Urdhrit të Psikologut (licensimi si psikolog), ndër të tjera, duhet të ketë përfunduar studimet Bachelor dhe Master në Psikologji. Ky program studimi nuk ofrohet në Psikologji, ose Psikologji Këshillimi (si një fushë e specializuar e psikologjisë), duke e vënë në pikëpyetje procesin e licensimit të studentëve të diplomuar në këtë program studimi në Urdhrin e Psikologut. Gjithashtu, në vijim të zbatimit të ligjit Nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit profesioni i mësuesit listohet ndër profesionet e rregulluara në nenin



nr. 5 “Profesionet e rregulluara”, pika g (psikologu listohet në pikën h të këtij neni). Ashtu sikurse përcaktohet në Nenin 7 “Formimi dhe kualifikimi profesional për ushtrimin e profesionit të rregulluar”, personi, që kërkon të ushtrojë një profesion të rregulluar, duhet të ketë përfunduar programin përkatës të akredituar të studimit dhe/ose kualifikime profesionale në atë profesion, të cilat vërtetohen me dokumente zyrtare, të lëshuara brenda ose jashtë vendit dhe të njohura në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nisur nga ky përcaktim ligjor, programi i studimit Bachelor në “Psikologji këshillimi dhe pedagogji”, nuk i jep mundësinë të diplomuarve të licensohen si mësues, pasi nuk është një program “përkatës” në fushën e mësuesisë.

## **GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

### **Përbërja e GVJ:**

- 1. Dr. Marjana Çadri**
- 2. Dr. Silvana Loka**

Menaxhere teknike e ndjekjes së këtij programi është Specialistja e SPVC, Znj Suela Kromidha.

Më datë 29.03.2019 është dërguar nëpërmjet sistemit por edhe zyrtarisht Draft RVJ në Institucion. Më datë 04.04.2019 vjen përgjigja/komente nga Institucioni nëpërmjet sistemit mbi këtë Draft. GVJ i pa me vëmendje këto komente dhe nuk merr në konsideratë asnjë prej tyre duke mos bërë ndryshim në Raportin përfundimtar.

Përgjigja e GVJ në lidhje me komentet e KUB për Draft RVJ është në fund të Raportit.

## **ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË**

### **I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit**

- Të përshtatet programi mësimor për të parashikuar më shumë lëndë/module që mbulojnë fushën e pedagogjisë.
- Të përmirësohen objektivat e programit të studimit pasi janë shumë të gjera.
- Të krijohen marrëveshje me institucione për realizimin e praktikës profesionale.
- Të rritet numri i personelit akademik të mirëkualifikuar në fushën e psikologjisë
- Të krijohen mundësi për të sjellë përvojat më të mira të shërbimit psikologjik nga vendet e tjera
- Të rritet numri i titujve dhe botimeve bashkëkohore në bibliotekën e institucionit

### **II. Plotësimi i tyre nga Institucioni**

- Në plotësim të rekomandimit “Të përshtatet programi mësimor për të parashikuar më shumë lëndë/module që mbulojnë fushën e pedagogjisë”, konstatohet se: Nga vlerësimi i kryer në syllabuset e programeve të studimit Bachelor rezulton se është rritur numri i moduleve për lëndët me zgjedhje të pedagogjisë. Kjo pasqyrohet edhe në informacionin RVB për riorganizimin e programit. Ashtu sikurse është paraqitur në RVB si dhe konfirmohet nga drejtuesi i Departamentit dhe anëtarët e stafit, shtimi i lëndëve të profilit të pedagogjisë është bërë në urgjencë për të përmbushur detyrimet që buronin nga Urdhëri i parë i Akreditimit, në pritje të miratimit për riorganizim të programit në tërësinë e tij.
- Në plotësim të rekomandimit “Të përmirësohen objektivat e programit të studimit pasi janë shumë të gjera”, konstatohet se: Objektivat e programit të studimit vazhdojnë të jenë të gjera, pasi edhe dy fushat që ky program synon të ofrojë janë dy fusha të veçanta formimi akademik dhe profesional.
- Në plotësim të rekomandimit “Të krijohen marrëveshje me institucione për realizimin e praktikës profesionale”, konstatohet se: Referuar RVB si dhe nga informacioni i vënë në dispozicion nga



koordinatorja e programit Znj. A. U. rezulton se institucioni ka të nënshkruara 56 marrëveshje bashkëpunimi me institucione arsimore, Univeritete publike dhe private, Bashki, Organizata komunitare brenda dhe jashtë vendit për organizimin e përbashkët të konferencave, projekteve, trajnimeve si dhe të praktikave profesionale të studentëve. Ashtu sikurse edhe përfaqësuesit e institucionit pranojnë, marrëveshjet janë kryesisht në fushën e edukimit, pasi edhe formimi në psikologji lidhet, në pjesën më të madhe të tij, me profilin e psikologut shkollor.

- d) Në plotësim të rekomandimit “Të rritet numri i personelit akademik të mirëkualifikuar në fushën e psikologjisë”, konstatuam se: Institucioni ka një numër shumë të vogël të stafit të angazhuar posaçërisht në fushën e psikologjisë (aktualisht vetëm një PAE ka përfunduar studimet Bachelor dhe Master në fushën e psikologjisë). Pjesa tjetër e stafit akademik efektiv është e një profile miks midis psikologjisë dhe pedagogjisë ose me një formim të plotë në fushën e pedagogjisë. Pjesa më e madhe e PAK janë të profilit të psikologjisë. Drejtuesi i departamentit, anëtarët e GVB si dhe anëtarët e stafit deklaruan se janë të ndërgjegjshëm për këtë përfaqësim shumë të ulët të stafit me profil të formimit akademik në psikologji.
- e) Në plotësim të rekomandimit “Të krijohen mundësi për të sjellë përvojat më të mira të shërbimit psikologjik nga vendet e tjera”, konstatojmë se: Institucioni ka mbështetur financiarisht anëtarë të stafit akademik për specializime të ndryshme jashtë vendit në fushën e psikologjisë dhe pedagogjisë si dhe ka organizuar shkëmbime eksperiencash të ndryshme me specialistë të fushës së psikologjisë.
- f) Në plotësim të rekomandimit “Të rritet numri i titujve dhe botimeve bashkëkohore në bibliotekën e institucionit”, konstatojmë se: Biblioteka e institucionit është mjaft e pasur me tituj të librave në fushat e psikologjisë dhe pedagogjisë, me mbi 6300 tituj. Institucioni ka në funksion një bibliotekë online aktive në shërbim të rritjes së nivelit të studimit edhe të këtij programi.



# ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi Bachelor në "Psikologji këshillimi dhe pedagogji" është hartuar dhe zbatuar në përputhje me qëllimet dhe objektivat e KU "Beder" për përgatitjen e specialisteve të lartë të psikologjisë, të pajisur me dije bashkëkohore në fushën e psikologjisë dhe pedagogjisë në përmbushje me nevojat e tregut të punës .

Ky program është mbështetur në kapacitetet që zotëron KU "Beder", në përvojën e fituar në fushën e arsimit dhe përgatitjes së specialistëve me kualifikim teoriko profesional. Niveli i lartë i mësimdhënies dhe praktikave profesionale, programeve dhe teksteve me nivel bashkëkohor realizohet nga një staf specialistësh, të fushës së metodikës, por janë të pakët ekspertët në fushën e psikologjisë.

Programi ofrohet nga Departamenti i Shkencave të Edukimit në Fakultetin e Filologjisë dhe Edukimit të Kolegjit Universitar "Beder". Fakulteti është i angazhuar në nxitjen e mendimit kritik intelektual i cili synon zhvillimin e kapaciteteve njerëzore në Shqipëri në rajon dhe më gjerë.

GVJ konstaton në planin strategjik afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjat të Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit është:

- Përgatitja e individëve të kualifikuar të Gjuhës dhe të Letërsisë Angleze, Gjuhës dhe Letërsisë Turke, Shkencave të Edukimit, Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji, programit Arsim Parashkollor dhe Fillor dhe fushave të ngjashme me to, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale; si dhe mbështetjen e kërkimit shkencor me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë
- Pajisja e studentëve me njohuri të përditësuara, të cilat i japin atyre mundësinë për të vazhduar studimet në ciklin e dytë të studimeve për të konkuruar në tregun e punës me njohuri, shprehi dhe aftësi të admirueshme.

Departamenti i Shkencave të Edukimit në KU "Beder" vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore në përputhje me Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë si pjesë përbërëse e Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit. Në këtë kuadër departamenti bashkërendon punën mësimore me veprimtarinë kërkimore duke respektuar liritë dhe te drejtat e personelit akademik si dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare të departamentit.

Departamenti i Shkencave të Edukimit ofron një arsim për të gjithë studentët e interesuar të ndërtojnë karrierën e tyre profesionale si në sektorin shtetëror dhe atë privat.

Programi Bachelor në "Psikologji këshillimi dhe pedagogji" synon të zhvillojë dhe të transferojë njohuri në fushën e psikologjisë përmes trajtimit teorik dhe praktikës së shërbimit psikologjik në shkolla, institucione të arsimit të lartë dhe mbështetjen tek kërkimi shkencor, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe të mbarë shoqërisë.

Programi Bachelor në "Psikologji këshillimi dhe pedagogji" është konceptuar në harmoni me misionin e përgjithshëm të KU "Beder" si dhe me standartet ndërkombëtare.



Kjo është bërë nëpërmjet ofrimit të një programi të kompletuar me të gjitha njohuritë e nevojshme në përputhje me misionin e edukimit, për të zgjeruar njohuritë rreth fushës sipas etikës profesionale, shkencës së sjelljes, për të përgatitur studentët për aplikimin e teorive dhe teknikave të këshillimit individual dhe në grup, në varësi të një përgatitje sa më të plotë profesionale në fushën e psikologjisë. Programi synon të përmbushë misionin e vet, duke ndihmuar studentët të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik, të komunikojnë qartë, të kuptojnë dimensionet etike të vendimeve që ata marrin dhe të njohin rolin dhe rëndësinë që ka shërbimi psikologjik në institucione të ndryshme arsimore publike dhe private.

Përgjegjësia profesionale e stafit akademik është edukimi i studentëve dhe përgatitja e tyre si profesionistë të së ardhshmes në mënyre që ata të mund të kryejnë detyrën e rëndësishme të psikologut. Por referuar RVB si dhe informacionet e mara në takimet e organizuara me drejtues të departamentit si dhe me stafin akademik konstatoam, se programi i studimit nuk është riorganizuar në përputhje me ligjin e ri "Për Urdhrin e psikologut në Republikës së Shqipërisë" të hyrë në fuqi më 26.05.2016. Kjo do të pamundësonte ushtrimin e profesionit të psikologut për studentët e diplomuar në këtë program studimi.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Programi Bsc në Psikologji këshillimi dhe pedagogji është hartuar në përputhje të plotë me qëllimet dhe misionin e institucionit për të kontribuar në ndërtimin e një profili social të tij si dhe për të plotësuar nevojat e tregut të punës në ekonominë shqiptare.</p> <p>Konstatuam se programet e studimit kanë të përcaktuara objektivat të cilat përfshijnë dijet aftësitë dhe kompetencat profesionale në funksion të pajisjes së studentëve me njohuri dhe konceptet bazë të studimit në fushën e psikologjisë së këshillimit dhe pedagogjisë.</p> <p>Institucioni shprehet se ka bërë një vlerësim të nevojave të tregut të punës. Gjithsesi, GVJ pranon se profili më i përshtatshëm në tregun e punës do të ishte "Psikologu Shkollor", gjë e cila do të kërkonte edhe rishikimin e programit të studimit.</p> <p>Programi në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji është risi në formimin e psikologëve dhe punonjësve sociale në shkollë pasi në nivelin e parë të studimit ai hedh bazat shkencore për nivelin e dytë të studimit për përgatitjen e psikologëve drejtuesve/orientuesve të nxënësve dhe fëmijëve në shkollë përsa i përket sjelljes dhe përshtatjes së tyre.</p>
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Programi Bachelor në Psikologji këshillimi dhe pedagogji është konceptuar në harmoni të plotë të misionit të përgjithshëm të KU "Bedër" me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Në planin strategjik, institucioni ka marrë parasysh ndryshimet në Ligjin e Arsimit të Lartë si dhe nevojat e tregut të punës në këtë fushë.</p> <p>Duke vlerësuar pjesën dokumentare të programit rezulton se programi i studimit Bachelor në "Psikologji këshillimi dhe pedagogji" është në përputhje me kriteret e përcaktuara si dhe me Kartën e Bolonjës. Programi i pajis studentët me njohuritë bazë për metodat dhe parimet shkencore të</p>



	<p>përgjithshme.</p> <p>Programet e studimit të Ciklit të parë synojnë pajisjen me aftësi të përdorimit të stileve të komunikimit, të njohjes së personalitetit, të etikës në këshillim, në aftësi të kërkimit shkencor si dhe në aftësimin për të krijuar një mjedis emocional pozitiv në respekt të etikës profesionale.</p>
<p><b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b></p> <p><b>Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;</li> <li>kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p>Konstatuam se programi i studimit është konceptuar në mënyrë të tillë që të orientojë studentët në preferencat tyre profesionale. Departamenti i Shkencave të Edukimit i harton politikat e zhvillimit në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik dhe kombëtar.</p> <p>Sektori i edukimit dhe institucionet arsimore paraqiten më prioritarë dhe me hapësira shumë dimensionale për punësimin e të diplomuarve të këtij institucioni.</p> <p>Në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik Departamenti i Shkencave të Edukimit ka kryer një studim vlerësimi për nevojat e tregut të punës. Në të përfshihen në mënyrë të detajuar mundësitë e punësimit të studentëve të diplomuar në rang kombëtar dhe ndërkombëtar, kërkesat e punëdhënësve, numri i të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra, kërkesat e maturantëve për këto programe studimi.</p>
<p><b>Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i ofruar në Bachelor në “Psikologji këshillimi dhe pedagogji” është hartuar në përputhje me politikat kombëtare të parashikuara në planin strategjik mbi arsimin e lartë. K.U. “Beder” synon që në këtë program të risë cilësinë dhe të sigurojë përshtatshmërinë e tij me zhvillimet e fundit të shkencës dhe të teknologjisë. Departamenti i Shkencave të Edukimit nëpërmjet programeve që ofron synon të kontribuojë në ruajtjen e vlerave kombëtare.</p> <p>Konstatuam se institucioni ka mundësuar bursa studimi disa studentëve shqiptarë nga Kosova dhe Lugina e Preshevës si dhe i ka kushtuar një vëmendje të veçantë promovimit të kulturës shqiptare me studentët e ardhur nga vende të ndryshme</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p>KU “Beder” si në nivel institucional ashtu edhe në nivel departamentesh apo programesh studimi, konstatohet se e zhvillon veprimtarinë e vet të mbështetur në standardet dhe kriteret e cilësisë.</p> <p>Programi i Studimit Bachelor në “Psikologji këshillimi dhe pedagogji” është hartuar duke mbajtur parasysh linjat themelore të misionit dhe qëllimeve për të cilat funksionon institucioni.</p> <p>Programi është në përputhje me strategjitë e zhvillimit të institucionit.</p>	

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Struktura akademike e Fakultetit të Fililologjisë dhe edukimit në KU “Beder” është përgjegjëse për programin Bachelor në “Psikologji këshillimi dhe pedagogji” është e strukturuar sipas Ligjit nr.80/2015. Ai përbëhet nga 3 njesi bazë të cilat janë



Departamenti i Shkencave të Edukimit,  
 Departamenti i Shkencave Kompjuterike  
 Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë Angleze.

## STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT TË FILOLOGJISË DHE EDUKIMIT



Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore shkencore të fakultetit. Departamenti ka për detyrë të nxisë, organizojë dhe të administrojë veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor duke respektuar liritë akademike të personelit dhe të drejtën për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të tij. Informacioni më i zgjeruar (*Aneksë, tabela 1 dhe Tabela 1/1*) për Stafin aktual në Departamentet përbërëse të këtij Fakulteti, jepet si më poshtë:

1. **Departamenti i Shkencave të Edukimit** ka në përbërje të tij 8 pedagogë efektiv (PAE), nga të cilët: 1 mban titullin Prof.As. 3 pedagogë mbajnë gradën shkencore “Doktor” dhe 4 pedagogë janë me diplomë Msc si edhe 3 pedagog me kontratë (PAK), nga të cilët: 2 pedagog me gradën Dr.dhe 1 me Msc.
2. **Departamenti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë Angleze** ka në përbërje të tij 8 pedagogë efektiv (PAE), nga të cilët: pedagogë mbajnë gradën shkencore “Doktor” dhe 3 pedagogë janë me diplomë Msc si edhe 1 pedagog me kontratë (PAK) me gradën Dr.
3. **Departamenti i Shkencave Kompjuterike** ka në përbërje të tij 7 pedagogë efektiv (PAE), nga të cilët: 3 pedagogë mbajnë gradën shkencore “Doktor” dhe 4 pedagogë janë me diplomë Msc si edhe 1 pedagog me kontratë (PAK) me gradën Dr.

Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga IAL (RVB) dhe takimeve që patëm në institucion, rezultojnë se për vitin akademik 2018-2019 Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit ka në përbërjen aktualisht 28 anëtarë, 23 prej të cilëve janë Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe 5 janë Personel Akademik me Kontratë (PAK).

Departamenti i Shkencave të Edukimit është njësi bazë mësimore-kërkimore dhe përfshin dy programe studimi të ciklit të parë në Bachelor në: “Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji”; “Arsimin Parashkollor dhe Fillor”, si dhe programin e ciklit të dytë të studimeve Master Shkencor në “Psikologji Këshilli dhe Pedagogji”

Referuar të dhënave të paraqitura në Dosjen e vetvlerësimit si dhe më konkretisht në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, (Aneksë, Tabela 2-7) stafi në vite në Departamentin e Shkencave të Edukimit jepet si më poshtë:

Viti akademik 2013-2014

**9 PAE** (1 Prof Dr; 4 Dr; 4 Msc) dhe **11 PAK** (1 Prof As; 2 Dr; 1 Doc; 5 Msc; 2 MA)

Viti akademik 2014-2015

**7 PAE** (2 Prof As; 1 Dr; 3 Dr në proces; 1 Msc) dhe **9 PAK** (1 Prof As; 1 Dr; 4 Dr në proces; 3 Msc)

Viti akademik 2015-2016

**8 PAE** (3 Prof.As; 3 Dr; 2 Dr në proces) dhe **11 PAK** (1 Prof. As; 2 Dr; 3 Dr në proces; 5 Msc)

Viti akademik 2016-2017

**7 PAE** (2 Prof. As; 3 Dr; 2 Msc) dhe **3 PAK** (3 Msc)

Viti akademik 2017-2018

**8 PAE** (1 Prof. As; 3 Dr; 4 Msc) dhe **5 PAK** (2 Dr; 1 Dr në proces; 2 Msc)

Viti akademik 2018-2019

**8 PAE** (1 Prof. As; 3 Dr; 4 Msc) dhe **3 PAK** (2 Dr; 1 Msc)

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Struktura akademike e Fakultetit

Struktura akademike e Fakultetit të Filologjisë dhe e Edukimit është në përputhje me Ligjin e Arsimit të lartë. Ai është i përbërë nga 3 njësi bazë.

- Departamenti i Shkencave të Edukimit ka në përbërje 8 (PAE)dhe 3(Pak)
- Departamenti i Shkencave Kompjuterike Ka në përbërje 7(PAE) dhe 1(PAK)
- Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë Angleze Ka në përbërje 8(PAE) dhe 1(PAK)

Nga analiza e treguesve të paraqitur në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RBV) dhe gjendja e konstatuar nga ana jonë, rezulton se nuk ka patur asnjë ndryshim në strukturën organizative të Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit të parashikuar në Statutin e KU "Bedër" dhe në VKM, Nr.286, datë 06.04.2011,për licensimin e Institucionit të Arsimit të Lartë , KU"Bedër".

### **3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit**

#### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Nga të dhënat e paraqitura në RVB por edhe në takimet e ndryshme që realizoi GVJ gjatë vizitës dy ditore në Institucion, GVJ konstaton se pesoneli akademik i anagazhuar në këtë program studimi është personel i brendshëm nga Departamenti ku ofrohet programi i studimit por edhe nga departamentet e tjera të këtij Institucioni. Gjithashtu në këtë program japin mësim edhe personel akademik i ftuar. Aktualisht, në këtë vit akademik, konstatohet se nuk ka Personel të brendshëm në këtë program studimi minimalisht me formim Dr në fushën e psikologjisë. Personeli DR është në fusha të pedagogjisë dhe të afërta me të.



Nga të dhënat e paraqitura në RVB për pesonelin akademik në vite, në pamje të parë duket së është po i njëjti personel i cili është në përbërjen e Departmentit të Shkencave të Edukimit ndër vite. Bie në sy që personeli i angazhuar në program është i pakët në përputhje me shumëllojshmërinë e lendëve që ofron programi Bsc. GVJ për të paraqitur personelin akadeimk në këtë program ndër vite, është mbështetur në të dhënat e RVB dhe konkretisht në tabelat 14-17 ku në kokë të tyre paraqitet stafi akademik në programin Bsc në “Psikologji këshillimi dhe pedagogji”

Referuar sa më sipër, personeli akademik në program paraqitet si më poshtë:

**Viti akademik 2013-2014**

9 PAE (1 Prof Dr; 4 Dr; 4 Msc) dhe 11 PAK (1 Prof. As; 2 Dr; 1 Doc; 2 MA dhe 5 Msc)

Mbulimi i programit është në masën 45 % nga PAE (9 PAE/11 PAK)

**Viti akademik 2014-2015**

7 PAE (2 prof.as; 1 Dr; 3 Dr në proces; 1 Msc) dhe 9 PAK (1 prof. As; 1 Dr; 4 Dr në proces; 3 Msc)

Mbulimi i programit është në masën 43 % nga PAE (7 PAE/9 PAK)

**Viti akademik 2015-2016**

8 PAE (3 Prof. As; 3 Dr; 2 Dr në proces) dhe 11 PAK (1 Prof. As; 2 Dr; 2 Dr në proces; 6 Msc)

Mbulimi i programit është në masën 42 % nga PAE (8 PAE/11 PAK)

**Viti akademik 2016-2017**

7 PAE (2 Prof. As; 3 Dr; 1 Dr në proces; 1 Msc) dhe 3 PAK (3 Msc)

Mbulimi i programit është në masën 70 % nga PAE (7 PAE/3 PAK)

**Viti akademik 2017-2018**

8 PAE (1 Prof. As; 3 Dr; 1 Dr në proces; 3 Msc) dhe 5 PAK (2 Dr; 1 Dr në proces; 2 Msc)

Mbulimi i programit është në masën 61 % nga PAE (8 PAE/5 PAK)

**Viti akademik 2018-2019**

7 PAE (1 Prof As; 2 Dr; 1 Dr në proces; 3 Msc) dhe 3 PAK (1 Dr dhe 2 Msc)

Mbulimi i programit është në masën 70 % nga PAE (7 PAE/3 PAK)

*Të dhëna më të detajuara, emër mbiemër, Detyra në Departament si dhe Institucioni ku punin full time për PAK janë në Aneksë tabela 8*

*Të dhëna më të detajuara për stafin akademik sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre janë në tabelat 9 ne Aneksë*

Njësia përgjegjëse për programin Bachelor në “Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji” ka një strukturë komplete të stafit akademik mësimdhënës, me pedagogë efektive dhe pedagogë me kohë të pjesshme, të rekrutuar mbi bazën e konkurimit dhe vjetërsisë në punë dhe të kontributeve mësimore dhe shkencore.

Bazuara në të dhënat e vëna në dispozicion nga IAL (RVB), informacioneve të mara në takimet e organizuara në këtë institucion si dhe dokumentacionit që kërkua për stafin akademik 2018-2019 në këtë program studimi, rezulton se stafi në këtë program për vitin akademik 2018-2019 jepet i ndryshëm në dokumenta të ndryshme. Paraqitet 10 PAE dhe 3 PAK në dokumentin e “Planit mësimor të shoqëruar me pedagogun përkatës sipas semestrave” dhe 11 PAE dhe 2 PAK në dokumentin “Për ngarkesën e pedagogëve në këtë program por edhe në programet e tjera në KU Bedër”.

Nisur nga të dhënat e paraqitura në RVB faqe 67-71, Plani mësimor i lidhur me pedagogun përkatës, janë nxjerrë këto shifra për mbulimin e programit:

**Viti akademik 2013-2014 – 10 PAE/8 PAK - 55% nga PAE**



10 PAE (1 Prof. Dr; 6 Dr; 3 Msc) dhe 8 PAK (1 prof. As; 3 Dr; 3 Dr në proces; 1 Msc)

**Viti akademik 2014-2015 – 11 PAE/7 PAK – 61% nga PAE**

11 PAE (1 Prof. Dr; 2 Prof. As; 4 Dr; 2 Dr në proces; 2 Msc) dhe 7 PAK (2 Prof. As; 1 Dr; 3 Dr në proces; 1 Msc)

**Viti akademik 2015-2016 - 9 PAE/5 PAK – 64% nga PAE**

9 PAE (1 Prof. As; 5 Dr; 1 Dr në proces; 2 Msc) dhe 5 PAK (2 Dr; 1 Dr në proces; 2 Msc)

**Viti akademik 2016-2017 – 12 PAE dhe 1 PAK – 92% nga PAE**

12 PAE (2 Prof. As; 4 Dr; 1 Dr në proces; 5 Msc) dhe 1 PAK (1 Dr në proces)

**Viti akademik 2017-2018 – 10 PAE/4 PAK – 71% nga PAE**

10 PAE (1 Prof. As; 3 Dr; 1 Dr në proces; 5 Msc) dhe 4 PAK (1 Dr; 1 Dr në proces; 2 Msc)

**Viti akademik 2018-2019 – 11 PAE/2 PAK – 84% nga PAE**

11 PAE (1 prof. As; 4 Dr; 6 Msc) dhe 2 PAK (1 Dr; 1 Msc)

*Për sa më sipër shiko Anekse Tabela 11*

Institucioni në realizimin e këtij programi studimi ka rritur numurin e personelit akademik me PAE në raport me PAK por rezultoi se numuri i punonjësve akademik me kualifikim në fushën e psikologjisë është i pamjaftueshëm. Në takimin e organizuar me stafin akademik të programit të studimit Bachelor në “Psikologji këshillimi dhe pedagogji” konstatuam se personeli akademik i kualifikuar është me grada shkencore në pedagogji ose në fusha të tjera.

Nisur nga të dhënat e paraqitura nga Institucioni të kërkuara gjatë vizitës në vend, GVJ konstaton se ngarkesa e stafit të brendshëm në këtë program është më e larta 308 orë (Msc A. U.) dhe më e ulëta 42 orë. Ndërsa ngarkesa e stafit jo vetëm në këtë program por edhe në programet e tjera të ofruara nga KUB luhatet nga 350 orë (Dr L. C) në 168 orë (Msc E.M), *Shiko Anekse, Tabela 10*

Gjithashtu GVJ konstaton se një pjesë e konsiderueshme e lëndëve për vitin akademik 2018-2019 mbulohen nga 4 pedagogë (Msc A. U - 8 lëndë; Msc E. M - 4 lëndë; Msc E. A. – 7 lëndë; Prof. As R. O. 4 lëndë)

Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe nga takimet e organizuara me stafin akademik konstatuam se në Programin e studimeve Bachelor në “Psikologji këshillimi dhe pedagogji” dominon staf akademik i seksit femër në raportin 8/3.

Të dhëna sipas moshës së personelit

Nga të dhënat sipas moshës së personelit që pasqyrohen në dokumentat bazë të personelit në kontratat e punës si dhe RVB konstatuam se dominon moshë 36-45 vjeç (6 PAE dhe 2 PAK) 25-35 (1 PAE dhe 3PAK) dhe 46-55 vjeç (1 PAE) .Vërehet një kombinim i moshave, specialiteteve dhe eksperiencave

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Në KU “Bedër” konstatuam se kontratat e punës që nënshkruhen me stafin akademik, janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kontrata e punës janë me afat/ose pa-afat të përcaktuar në bazë të kategorisë së stafit akademik dhe kohës së punësimit. Në to përshkruhen në mënyrë të detajuar të drejtat dhe detyrimet që kanë palët nënshkruese të kontratës. Këto të drejta dhe detyrime i bëhen të ditura stafit në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe aneksit të saj. Kontrata e punës bazohet në ligjin nr. 80/20 15 datë, 22.7.2015 “Për arsimin e Lartë”.



Gjatë takimit me stafin akademik u vu re informimi i tyre për detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë për vendin e punës dhe në zyrën e burimeve njerëzore u njohëm me dokumentacionin për disa anëtarë të personelit akademik efektiv dhe me kontratë.

Dokumentacioni i zyrës së burimeve njerëzore ishte i plotë, i organizuar mirë dhe në mënyrë profesionale, elektronikisht dhe në hardcopy në përputhje me kërkesat e institucionit dhe kodit të punës.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Si për çdo njësi bazë dhe në Departamentin e Shkencave të Edukimit që është përgjegjës për programin Bachelor në “Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji” ka një sekretare që funksionon si mbështetje për mbarëvajtjen e punës në këtë departament. Gjate vizitave në institucion patëm mundësinë të kontaktojmë me personelin mbështetës si sekretare e departamentit dhe punonjëse të sekretarisë mësimore. Konstatuam se stafi ndihmës /administrative për çdo njësi bazë është i pajisur me kontratë e punës dhe konstatuam se janë të mirëinformuar për detyrat, përgjegjësitë dhe të drejtat e tyre.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë ditëve të vizitës u konsoliduan dhe provuan të dhënat e përmbledhura në RVB si dhe u kontaktua direkt me personelin akademik dhe atë administrativ për të marrë vlerësimet e tyre për programin e studimit Bachelor në “Psikologji këshillimi dhe pedagogji” dhe funksionimin e institucionit të KU “Beder”. Në përgjithësi ekziston një frymë pozitive midis personelit akademik. Ata ndihen të vlerësuar profesionalisht, nga pikpamja financiare dhe ajo sociale.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>III - PERSONELI I INSTITUCIONIT</b>	
<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>KU “Beder” për rekrutimin e personelit, konstatuam se mbështetet në procedura ligjore dhe transparente si dhe në përputhje me statutin dhe rregulloren për punësim.</p> <p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit, dhe mbështetur edhe në të dhënat e paraqitura më sipër, rezulton se programi për vitin akademik 2018-2019 mbulohet në masën 84% nga personeli akademik i brendshëm. Vlen të theksohet se ndër vite kjo masë ka ardhur duke u përmirësuar.</p> <p>Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësia bazë.</p> <p>Pas miratimit nga Dekani dhe Rektori të nevojave konstatuam se fillon procedura me ngritjen e komisionit had-hoc i cili bën renditjen e kandidatëve dhe ja paraqet për miratim rektorit.</p> <p>Në takimet e organizuara në KU “Beder” konstatuam se personeli efektiv dhe ai me kontratë rezultoi të jetë i informuar në lidhje me procedurën e vlerësimit. Në institucion vlerësimi bëhet duke ndjekur procedura ligjore dhe transparente.</p> <p>Politikat dhe strategjia e punësimit të personelit përcaktohet në statut dhe në rregulloren dhe procedurat e punësimit ku parashikohen procedurat që ndiqen për punësime personelit me kohë të plotë dhe me kohë të</p>



	<p>pjesshme. Nga verifikimi i dokumentacion në këtë institucion rezulton një përvojë e mire në lidhje me zbatimin e procedurave të punësimit si dhe mirmbajtjes së dokumentacionit të personelit.</p>
<b>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studi</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor., ose titullin akademik “Docent.,.</p>	<p>Institucioni disponon dosje të kompletuara me një bazë të plotë të dhënash të trupës mësimore, me kohë të plotë dhe kontrata pune. Të dhënat e anëtarëve të personelit akademik përkojnë me objektivat dhe misionin për realizimin e programit të studimit. Nga studimi i dosjes së personit përgjegjës për programin e studimit rezulton se ka gradën Msc (Dr në proces). KU”Beder” disponon një listë të plotë të stafit akademik dhe administrativ të miratuar nga Senati akademik. Verifikimi nga ana jonë e kësaj liste dëshmon përputhjen e programeve të studimit me listën e personelit të punësuar në këtë institucion.</p> <p>Konstatuam se rekrutimi i personelit akademik kryhet me procedura të rregullta me transparencë dhe objektivitet. Njoftimet për vendet e reja si dhe rezultatet pas konkurimit shpallen në faqen online të institucionit dhe janë të dokumentuara në dosjet e personelit.</p> <p>Për realizimin e programit të studimit Bachelor në “Psikologji këshillimi dhe Pedagogji” institucioni kryesisht ka angazhuar titullarë me gradën shkencore Dr, përgjithësisht në fushën e Pedagogjisë.</p> <p>Nga takimet e organizuara me stafin konstatuam se një titullare është në proces doktorature dhe pesë titullarë me Msc.</p> <p><u>Rezulton se jo të gjithë titullarët e lëndëve /moduleve kanë kualifikimin e nevojshëm në përputhje me kërkesat ligjore.</u></p>
<b>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Programi i studimit në përmbajtje të tij nuk ka të parashikuara orë laboratorike. Në ndihmë të studentëve janë orët e praktikave profesionale të cilat konstatuam se mbështeten nga stafi ndihmës mësimor shkencor i cili aktivizohet edhe në ndihmë të realizimit të procesit mësimor në varësi të nevojave të programit.</p> <p>Referuar RVB dhe të dhënave të marra nga të gjitha takimet e organizuara në institucion me stafin akademik si dhe me studentët rezulton se në KU ”Beder” ka një angazhim të plotë të burimeve njerëzore në përmbushje të objektivave të programeve të studimit të ciklit të parë</p> <p>Nga takimi i organizuar me përfaqësues te Zyrës së Planifikimit të Karrierës u informuam se kjo zyrë kontribuon në zhvillimin e praktikave profesionale në bashkëpunim edhe me pedagogët e lëndës së praktikës profesionale. Mbështetur edhe në interesat e studentëve praktika profesionale kryhet e organizuar në grupe të vogla nën drejtimin e pedagogëve. Institucioni ka vënë në dispozicion Pedagogë mbikqyrës në raportin 1/10 studentë.</p>
<b>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b>	



<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Ashtu sikurse u konfirmua në Zyrën e Burimeve Njerzore dhe Zyrën e Njesisë së Sigurimit të Cilësisë në KU "Beder" punohet sipas një planifikimi të mirëmenduar për trajnimin dhe integrimin e stafit. Këtë gjë e pamë edhe në faqen e NJSBC. Planifikimi i trajnimeve bëhet mbështetur në kërkesat e stafit në lidhje me tematikën dhe që do të trajtohen. Trajnimet e kualifikimet profesionale të personelit akademik dhe të personelit mësimor-shkencor organizohen me mbështetje të institucionit me specialistë brenda apo jashtë vendit.</p> <p>Referuar RVB si dhe konstatimit nga ana jonë rezultoi se institucioni ka një bazë të dhënash të përditësuara të programeve të studimit të cilat i ka të mirëorganizuar në hard-copy dhe në mënyrë elektronike</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>Institucioni ndjek procedurat ligjore të rekrutimit të personelit me transparencë dhe me objektivitet dhe disponon një bazë të dhënash për personelin e tij dhe një dokumentacion të plotë për veprimtarinë akademike në hard-copy dhe në formë elektronike.</p> <p>Angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të programit bachelor në "Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji"</p> <p>KU "Beder" planifikon dhe mbështet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme.</p> <p>Rezultoni se jo të gjithë titullarët e lëndëve /moduleve kanë kualifikimin e nevojshëm në përputhje me kërkesat ligjore</p>	

#### 4. **Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

##### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Mbështetur në të dhënat e deklaruara në RVB, GVJ konstaton se KU "Beder" ka një mjedis prej 5628 m<sup>2</sup> të ndarë në dy godina: Godina A është 8 katëshe dhe aty ndodhen sallat ku zhvillohet mësim, muzeu, salla e gjyqit, laborator i informatikës, biblioteka, mjedise për shërbime studentare, dhe shëndetësore. Godina B është 2 kateshe, ku krahas klasave ka ambjente për zhvillimin e karrierës dhe të aktiviteteve ekstrakurrikulare si dhe ambjenti i paletres që shfrytëzohet nga studentët dhe stafi për aktivitete sportive.

Godinat kanë një infrastrukturë me ngrohje, janë të pajisura me vidioprojektore, tabela inteligjente për zhvillimin e procesit mësimor. Institucioni ve ne dispozicion 8.1m<sup>2</sup> për cdo student si dhe 1 libër për 15 studentë.

Institucioni ka plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme për ndriçim natyral, për ngrohje edhe me alternativë, dalje si dhe shkallë emergjence. ka sistem mbrojtje kundra zjarrit.

##### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Mjediset për Programin e studimit

Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit	Sasia	Sipërfaqja
Salla për leksione	4	358
Klasa për seminare	13	686
Salla për aktivitete promovuese	1	268.6
Salla për praktikë lëndore/ profesionale	1	25
Laboratorë për lëndët	1	350
Laboratorë informatike	1	44.6
Salla interneti	1	40
Salla për bibliotekë	1	230
Mjedis për fotokopjime, librari etj	1	16
Zyrë informacioni për studentët	3	75
Korridore/holle	25	1807.7
Mjedise sportive	1	150
Mjedise shërbimi për të tretë	1	40
Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore	1	32
Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj	1	80
Nyje hidrosanitare për studentët	38	171
Etj....		370
<b>Norma m<sup>2</sup>/për student</b>	<b>8.1</b>	

- Salla për leksione 4
- Klasa për seminare 13
- Salla për aktivitete promovuese 1
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale 1
- Laboratorë për lëndët 1
- Laboratorë informatike 1
- Salla interneti 1
- Salla për bibliotekë 1
- Mjedis për fotokopjime, librari etj 1
- Zyrë informacioni për studentët 3
- Nyje hidrosanitare 38

Mjediset për stafin:



<input checked="" type="checkbox"/> Mjedise për Dekanin/ kancelarin	4
<input checked="" type="checkbox"/> Zyra për sekretarinë mësimore	1
<input checked="" type="checkbox"/> Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore	6
<input checked="" type="checkbox"/> Zyra për personelin akademik	16

Mjediset për stafin:	Sasia	Sipërfaqja
Zyra për Dekanin/zv dekanin/ kancelarin	4	180
Zyra për sekretarinë mësimore	1	35
Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore	6	105
Zyra për personelin akademik	16	340
Zyrë për financën	1	14
Zyrë për Njësinë e SBC	1	21
Salla për mbledhje	2	94
Mjedis për stafin e shërbimit	2	30
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	13	65
<b>Norma m<sup>2</sup>/për person</b>	9.4	

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Nga RVB-ja dhe vizita në institucion e KU "Beder" pamë një bibliotekë efikase dhe me tekste bashkëkohore. Shumica e teksteve të detyrueshëm për programin e studimit ishin në bibliotekë kurse për literaturën shtese mund ta aksesonin në bibliotekën online.</p> <p>Stafi akademik dhe studentët kanë në dispozicion një fond prej 36000 titujsh të bibliotekës dhe një numër të madh titujsh botimesh shkencore, revistash periodike e cila vjen duke u pasuruar vazhdimisht ne përmbushje te kerkesave të departamenteve dhe nevojave për një informacion sa më bashkëkohor.</p> <p>Nga vizita në bibliotekë konstatoam sistemin e automatizimit të instaluar për regjistrim dhe kërkim nga ana e studentëve për litaraturën e nevojshme. Kjo gjë mundësohet nga abonimi që është bërë në sistemin EBSCO Host që i ofron studentëve të kenë akses për 45 000 tituj librash dhe 5000 revista.</p> <p>Biblioteka e KU "Beder" mundëson komunikimin edhe në Book Academic collection.</p> <p>Biblioteka ka vënë në dispozicion të studentëve Bachelor në "Psikologji këshillimi dhe pedagogji" një numur titujsh tekstesh, në mbështetje të programit dhe buxhetit të</p>



	<p>planifikuar nga institucioni si dhe në sërë monografish, revistash të cilat përmbajnë informacionin e duhur dhe për përgatitjen e punimeve me karakter shkencor dhe temave të diplomës. Nga RBV dhe komunikimi me studentët në bibliotekë u njohëm me projektin studentor “Unë dhuroj, dhuro dhe ti” për grumbullimin e librave dhe pasurimin e bibliotekës me një numur prej 10000 mijë librash.</p> <p>Biblioteka shërbente nga e hëna në të shtunë me orare të përshtashme (08:30-19:00) për studentët dhe pedagogët, dhe ka ambiente optimale të cilat sigurojnë kushte për studim .</p>
<p><b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, lingvistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>Referuar RVB si dhe vizitës në institucion konstatuam se: Institucioni ofron mjedise të mjaftueshme për realizimin e programit mësimor si qendra e medias dhe komunikimit, laboratorin e gjuhëve të huaja, laboratorin e informatikës, sallë gjyqi për zhvillimin e praktikave profesionale si dhe pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit të cila vihen në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve në realizimin e programit mësimor.</p> <p>Në përputhje me programet mësimore intitucioni ka vënë në dispozicion pajisjet që plotësojnë në mënyrë funksionale mjediset për mësimdhënie të tilla si dërrasa interactive, kompjutera, internet si dhe salla të pajisura dhe me ndricim dhe ngrohje të përshtatshme.</p> <p>Në programin Bachelor në “Psikologji këshillimi dhe pedagogji” e ofruar për riakreditim <b>nuk</b> janë parashikuar punë laboratorike për vet specifikën që ka programi.</p> <p>Institucioni në realizimin e këtij programi ka vene në dispozicion Qendrën e Medias dhe Komunikimit si dhe Sallën e Gjyqit ku janë organizuar seanca praktike në përputhje me programet lëndore.</p> <p>Mbështetur në RVB si dhe në vëzhgimet e kryera gjatë vizitës në institucion rezultojnë se në dispozicion të realizimit të programeve lëndore janë vënë laboratorin e teknologjisë dhe informacionit, si dhe portali informativ.</p> <p>Referuar RVB si dhe informacioneve e vëna në dispozicion nga studentët në takimet e organizuara në institucion rezultojnë se për zhvillimin e praktikave profesionale institucioni ka nënshkruar marrëveshje me DAR-Tiranë, Lezhë, me institucionet e edukimit të Turgut Ozal si dhe me sh.p.k Gulistan. Po kështu ka mundësuar zhvillimin e praktikave profesionale pranë zyrave të institucionit si ato të Burimeve Njerzore, Zyrës së Zhvillimit të karrierës. Po kështu studentët na informuan se kanë asistuar në projektet e Zyrës së kërkimit shkencor.</p>
<p><b>Konkluzione të GVJ:</b></p>	
<p>Institucioni ofron mjedise të mjaftueshme për realizimin e programit mësimor si dhe qendra e medias dhe komunikimit, laboratorin e gjuhëve të huaja, laboratorin e informatikës, sallë gjyqi për zhvillimin e praktikave profesionale.</p> <p>Në përputhje me programet mësimore intitucioni ka vënë në dispozicion pajisjet që plotësojnë në mënyrë funksionale procesin e mësimdhënies.</p> <p>Referuar RVB si dhe informacioneve të vëna në dispozicion nga studentet në takimet e organizuara rezultojnë se për zhvillimin e praktikave profesionale institucioni ka nënshkruar marrëveshje me institucionet e edukimit</p>	



## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Për këtë rubrikë, GVJ është mbështetur në të dhënat e deklaruara nga RVB si edhe në dokumentacionin shoqëruar të këtij raporti.

Gjatë shqyrtimit të RVB, GVJ konstaton se: Burimet e financimit institucionit janë pagesat e studentëve dhe donacionet. Mbështetur në legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë, institucioni ka të drejtë të pranojë mbështetje financiare dhe materiale në përputhje me objektin e veprimtarisë së tij.

Kostoja për student për vitin akademik është si më poshtë:

Viti akademik 2013-2014 ishin 177,066 ALL, Viti akademik 2014-2015 ishin 210,543 lekë, Viti akademik 2015-2016 ishin 215, 763 lekë, Viti akademik 2016-2017 ishin 165,449 dhe në Vitin akademik 2017-2018 ishin 153,619 lekë.

Institucioni kontrollohet në mënyrë të rregullt nga institucionet shtetërore financiare, mban kontabilitet të rregullt dhe mer ndihmen e nevojshme për probleme tatimore, kontabiliteti nga eksperte të jashtëm financiarë. KU "Beder" është në menaxhimin financiar të Fondacionit Hafiz Ali Korca.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje, Shiko Anekse, tabela 12 dhe 13):

Grantet për kërkim për vitin akademik 2013-2014 është 206,000 dhe për vitin akademik 2016-2017 është 1,312,193

Konsulencat, shërbimet për vitin akademik 2013-2014 është 1,216.000; për vitin akademik 2015-2016 është 2,176,640, për vitin akademik është 2016-2017 është 166,652, për vitin akademik 2017-2018 është 9,027,774 dhe për vitin aktual akademik 2018-2019 është 376,050.

Tarifat për dhe gjatë shkollimit: 2013-2014 është 69,279,180; 2014-2015 është 72,676,750; 2015-2016 është 85,746,511; për 2016-2017 është 81,141,671; 2017-2018 është 64,625,526 dhe për 2018-2019 është 28,011,220.

Sponsorizime nuk ka

Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) nuk ka

Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj 2013-2014 është 48,463,997 ;për 2014-2015 është 97,021,093; për 2015-2016 është 72,079,844për 2016-2017 është 33,359,263 për 2017-2018 është 28,350,000; dhe për 2018-2019 është 1,224,600.

Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) nuk ka .

- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Shpenzimet për student për vitin akademik është si më poshtë:

Viti akademik 2013-2014 ishin 177,066 ALL, Viti akademik 2014-2015 ishin 210,543 lekë, Viti akademik 2015-2016 ishin 215, 763 lekë, Viti akademik 2016-2017 ishin 165,449 dhe Viti akademik 2017-2018 ishin 153,619 lekë.

Mbështetur në të dhënat e mësipërme rezulton se shpenzimet për studentët nga viti 2016 kanë ardhur në ulje.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
---------------------	-------------------------



**II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**  
**Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.**

**Kriteri 1** Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;

**Kriteri 2** Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;

**Kriteri 3** Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.

Ashtu siç është e paraqitur edhe në RVB, mbështetur në legjislacionin në fuqi institucioni bën auditimin e situatës financiare me ekspertë të jashtëm dhe harton raporte financiare ku pasqyrohet të ardhurat nga tarifat e shkollimit, kontributeve të tjera financiare dhe e shpenzimeve. Raporti financiar bëhet çdo vit. Një kopje i vihet në dispozicion MASR.

Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj Eksperti i auditit konstaton se burimet financiare dhe përdorimi i tyre bëhet në bazë të një programi financiar i hartuar në përputhje me standartet kombëtare të hartimit të raportimit KU "Beder" ka mbështetjen e donatorëve dhe ka kapacitete të mjaftueshme financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme për të ardhmen. Zhvillimi i programit të studimit Bachelor në "Psikologji këshillimi dhe pedagogji" ka mbështetjen financiare të institucionit

**VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR**  
**Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.**

**Kriteri 1** Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;

**Kriteri 2** Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;

**Kriteri 3** Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.

Bazur në RVB konstatohet se për çdo vit kalendarik hartohen pasqyrat financiare në zbatim të standarteve të kontabilitetit dhe të ligjit përkatës.

Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj Zyra e financës dokumenton raportet vjetore financiare për tre vitet e kaluara

Konstatuam se gjendja financiare paraqitet e qëndrueshme me kapacitete financiare të mjaftueshme për të garantuar ecurinë normale të programeve të studimit.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Institucioni kryen veprimtarinë financiare në përputhje me detyrimet ligjore dhe nën ligjore në fuqi dhe përgatit raporte financiare vjetore për të gjitha njësitë.

KU "Beder" dokumenton aktivitetin financiar nëpërmjet pasqyrave financiare vjetore dhe auditimit të përvitshëm të llogarive të tij, nga ekspertë kontabël të regjistruar.

Gjendja financiare e institucionit është në parametra optimale dhe mundëson përmirësimin e metejshëm të parametrave për rritjen cilësore të mësimdhënies dhe përmirësim të shërbimeve për çdo studentet.

**6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë**

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Bazuar në RVB, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe Komisioni i Përhershëm për garantimin e standarteve të sigurisë institucionale në KU "Beder" janë ngritur sipas standarteve të përcaktuar MASR. Ajo e ushtron aktivitetin e saj dhe është përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive



mësimore, kërkimore-shkencore dhe i raporton drejtpërdrej të Rektorit. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) përbëhet nga pesë anëtarë nga të cilët tre janë pjestarë të stafit akademik me kohë të plotë, një ekspert i jashtëm dhe një student. Në takimin me përfaqësuesit e NJBSC, GVJ mori informacion për mënyrat se si funksionon kjo njësi në KU "Beder". NJBSC ka një sërë kompetencash në lidhje me politikën, procedurat, vlerësimet e programeve etj.

Pas çdo vlerësimi raporton rezultatet dhe bën propozimet përkatëse para Senatit Akademik.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

- Sa anketime kanë bërë

Mbështetur në informacionin e RVB në institucion janë realizuar 12 anketime me studentët.

- Sa studentë janë anketuar?

Janë ftuar të marrin pjesë në anketim të gjithë studentët e programeve të studimeve.

- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë?

Nëpërmjet anketimeve kanë dalë probleme për infrastrukturën, logjistikën si dhe për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve.

Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm

Pasi janë konstatuar problemet, ashtu sikurse deklarohet në RVB si dhe nga informacioni i dhënë nga drejtuesit e institucionit, rezulton se nga ana e institucionit po merren masat për përmirësimin e infrastrukturës dhe të shërbimeve.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë në institucion ka si funksion kryesor garantimin e cilësisë, përmirësimin e vazhdueshëm të saj, në arritjen e objektivave të përcaktuara. Procedurat e vlerësimit organizohen sipas një rregulloreje të brendshme të institucionit, e cila përfshin vlerësimet e studentëve për stafin akademik dhe stafin administrative si dhe vetvlerësimet e stafit akademik. Të gjitha përfundimet e marra nga këto tre burime, analizohen me qëllim nxjerrjen e përfundimeve për situatën aktuale si dhe për përpilimin e sugjerimeve për përmirësimin e situatës në vijim.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti (*Shiko Anekse, Tabela 14*)

Bazuar në RVB dhe në takimet e realizuara me përfaqësuesit e kësaj zyre, garantimi dhe rritja e vazhdueshme e cilësisë nuk është vetëm detyrë e NJBSC, por e rëndësishme është të krijohet dhe zhvillohet kultura e cilësisë në çdo njësi të funksionimit akademik dhe administrativ të KU "Beder". Ngritja e GVB pranë Fakulteteve, përfshirja në to edhe e studentëve i shërben pikërisht këtij synimi. NJBSC monitoron dhe menaxhon profesionalisht cilësinë duke bashkëpunuar me GVB të fakulteteve. Në takimin me NJBSC, u konstatua se monitorimi dhe menaxhimi i cilësisë shkonte deri në nivel departamenti.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Vetëvlerësimet janë vjetore dhe kryhen nga NJSBC. Ato shërbejnë për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies dhe për të marrë masat e nevojshme të përmirësimit të saj. GVJ u njoh me rezultatet e vetëvlerësimeve në vitin akademik 2017-2018.





Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Referuar RVB si dhe nga informacionet e mara në takimin me stafin akademik rezultoi se programi i studimit është vlerësuar nga anketat e studentëve si dhe nga stafi i brendshëm. Gjithsesi sipas RVB, në të ardhmen NJBSC nëpërmjet GVB-ve do të realizojë ndjekjen sistematike të vazhdimësisë së programit duke patur në fokus përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b> <b>Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;</li><li>b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;</li><li>c. Pyetje konceptuale;</li><li>d. Intervista;</li><li>e. Etj.</li></ul> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>a. Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);</li><li>b. Dëgjime në auditor;</li><li>c. Vlerësimi me nota/pikë;</li><li>d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</li><li>e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatat);</li><li>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li><li>g. Etj.</li></ul>	<p>Në strukturën e organizimit të KU "Beder" ushtron veprimtarinë Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, e cila është pjesë e strukturës së organizimit të KU "Beder".</p> <p>Kjo Njësi e ushtron veprimtarinë e saj si njësi e përhershme dhe ka për detyrë të vlerësojë ecurinë e programeve të studimit nëpërmjet instrumentave matës dhe vlerësues, të cilat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Sondazhet e studentëve që ndjekin programet studimore, të cilët në përfundim të ciklit të studimit, nëpërmjet pyetësorëve, japin opinionet e tyre për cilësinë e mësimdhënies, cilësinë e programeve, teksteve, etj.</li><li>- Pyetësorëve për studentët, të cilët plotësohen në fund të semestrave dhe japin informacion për aftësitë profesionale të pedagogëve, cilësinë e komunikimit në auditore, përdorimin e metodave të reja në mësimdhënie dhe praktika mësimore.</li><li>- Intervista me kampione studentësh ose fokus-grupe për secilin program studimi. Ky kampion zgjidhet në mënyrë rastësore nga anëtarët e njësisë, me qëllim grumbullimin e një informacioni sa më objektiv.</li><li>- Sondazhe të studentëve të cilët kanë përfunduar programin e studimit. Nëpërmjet këtyre sondazheve me studentet "Alumni", njësia arrin të mbledhë një informacionin të nevojshëm mbi nivelin e arritur. NJBSC përpunon të dhënat e grumbulluara, rezultatet e të cilave i vihen në dispozicion, në mënyrë konfidenciale, stafit akademik.</li></ul> <p>Për kryerjen e vlerësimit NJBSC përdor metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, lëndëve/kurrikulës, dhe të të mësuarit.</li></ul> <p>Të drejtpërdrejta</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Dëgjime në auditor të cilat realizohen nga shefi i departamentit dhe nje anëtar i NJSCB;</li><li>• Rezultatet e arritura nga studentët bazuar në provimet e vlerësuara me nota ose pikë;</li><li>• Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare.</li></ul>



	<p>Bazuar në këtë metodologji, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë ka arritur në përfundimin se: Programi Bachelor në “Psikologji këshillimi dhe Pedagogji”, e cila ofrohet nga institucioni KU “Beder”, duhet të jetë e mirëorientuar ndaj kërkesave për procedurat e nevojshme për punësim.</p>
<b>VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË</b>	
<b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në vitin 2013 nga APAAL dhe në vitin 2017 nga Agjensia Britanike e Akreditimit “Quality Assurance Agency” në bashkëpunim me ASCAL.</p> <p>Referuar RVB konstatojmë se KU “Bedër” përdor Njësien e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe dy komisione të përhershme si: Komisioni i përhershëm i kërkimit shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionet si dhe Komisionin për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit.</p> <p>Ky funksion primar realizohet i përqendruar kryesisht nga një strukturë e mirëorganizuar dhe operative sikurse është NJBSC, e cila në punën e saj përdor metoda për kontrollin e cilësisë dhe mbikëqyrjen e saj. Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik.</p> <p>Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë, së bashku me njësitë e tjera të institucionit, ushtron kontroll të vazhdueshëm për cilësinë e mësimdhënies në të gjithë komponentët e veprimtarisë mësimore e shkencore.</p> <p>Kjo njësi bën vlerësimin e programeve studimore duke u përqendruar kryesisht tek Syllabuset, me synimin që ato të mos interferojnë me disiplina të tjera, por të realizojnë lidhje ndërdisiplinore. Në lidhje me përputhshërinë e literaturës me programin, shikohet nëse ka nivel shkencor të kohës, përshtatet me nivelin e dijeve dhe aftësive të studentëve. Në rastet kur studentët kanë stadi të avancuara, kërkohet pasurimi i literaturës me tituj të rinj, me qëllim që të rriten aftësitë dhe niveli shkencor i dijeve të studenteve.</p> <p>Senati i institucionit, merr në analizë praktika të testimit të cilësisë së programeve të studimit të disiplinave të ndryshme dhe të veprimtarive me karakter mësimor-shkencor.</p> <p>Institucioni për ndërgjegjësimin e personelit dhe të studentëve ve në dispozicion Manualin e Sigurimit të Cilësisë si dhe Guida për Studentët ku evidentohen qartë rëndësia e cilësisë dhe sigurimi i saj në funksion të kërkimit shkencor dhe të përmirësimit të mësimdhënies.</p> <p>KU “Bedër”, sipas RVB, ka hartuar dhe zbaton që në vitin 2012 planin strategjik 5-vjeçar në përmbushje të misionit të institucionit. U vumë në dije se aktualisht është hartuar një plan i ri strategjik 2018-2023. Strategjia, politika dhe procedurat janë të aksesueshme në faqen e institucionit Bedër.</p>



### Konkluzionet e vlerësimit:

KU "Beder" realizon sigurimin dhe mbikqyrjen e cilësisë në përputhje me standartet e kërkuara duke përdorur në mënyrë të vazhdueshme instrumenta të matjes dhe të vlerësimit si intervista, anketime etj.

Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë KU "Beder" i ka krijuar mekanizmat e nevojshëm institucionalë për të garantuar cilësinë. Konstatuam se kjo njësi është funksionale dhe e mirëingranuar në kontrollin e mbikqyrjen e cilësisë dhe kontribuon duke dhënë sugjerime dhe rekomandime për Senatit Akademik.

Kjo njësi bën vlerësimin e programeve të studimeve duke u përqendruar kryesisht në Syllabuset, me synimin që syllabuset e programeve të ndryshme të mos interferojnë midis tyre, por të realizojnë lidhje ndërdisiplinore.

## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

### 7. Programi i studimit, organizimi i tij

#### Pjesa përshkrimore



**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

GVJ konstaton se misioni i programit të studimit Bachelor në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji është në përputhje të plotë me misionin e vetë Departamentit të Shkencave të Edukimit, i cili është përgatitja e individëve të kualifikuar në fushën e psikologjisë së këshillimit dhe pedagogjisë, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale si edhe mbështetja e kërkimit shkencor, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë.

Ky program ka si objektivi të tijin formimin e psikologëve këshillues dhe mësimdhënës gjithashtu. Programi është i një natyre të përzier midis psikologjisë dhe pedagogjisë duke synuar të krijojë një profil të përshtatshëm për të siguruar punësimin e të diplomuarve si psikologë ose mësues.

Ashtu sikurse është paraqitur edhe më sipër, programi i studimit është licensuar me urdhër Nr. 330 datë 07.08.2012 dhe është akredituar me urdhër Nr. 223, datë 04.06.2013. Në përfundim të procesit të akreditimit, grupi i jashtëm i vlerësimit ka dhënë disa rekomandime, ndër të cilat edhe rekomandimin për një rishikim të kurrikulës duke theksuar shtimin e lëndëve të profilit "Pedagogji", për të qenë në përputhje sa më të plotë me emërtimin e përzier "Psikologji këshillimi dhe Pedagogji" që përmbante ky program studimi. Në zbatim të këtij rekomandimi, sikurse paraqitet në raportin e GVB, dhe ashtu sikurse sqaruan edhe Drejtuesi i Departamentit dhe stafi akademik, shtimi i lëndëve me profil pedagogjik është bërë kryesisht në grupin e lëndëve me zgjedhje. Në shkresën me Nr. 99/1 prot, datë 29.09.2017 "Kërkesë për riorganizimin e gjashtë programeve" të drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, janë paraqitur ndryshimet të cilat do ta përputhnin programin e studimit "Psikologji këshillimi dhe Pedagogji" me rekomandimet e dhëna në Urdhërin e Akreditimit. Ashtu sikurse cilëson si drejtuesi i departamentit edhe GVB, ende nuk ka një kthim përgjigje nga MASR. Kjo ka detyruar Departamentin që grupin e lëndëve të profilit të Pedagogjisë t'i shtojë në grupin e lëndëve me zgjedhje. Gjithashtu, vlen të theksohet se GVJ iu pohua si nga drejtuesi i departamentit edhe nga takimi me GVB, se Departamenti nuk ka bërë ndryshimet përkatëse në vijim të VKM, Nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" dhe viti akademik 2018-2019 ka vijuar me programin mësimor të mëparshëm, vetëm me ndryshimet e sipërpërmendura në grupin e lëndëve me zgjedhje.

Ndërkohë, përgjatë kohës kur është marrë Akredimi i parë përmes Urdhërit Nr. 223, datë 04.06.2013, kohës për përshtatje të programit mësimor me rekomandimet e vendimit të Akreditimit me urdhër Nr. 223, datë 04.06.2013 dhe momentit kur i është drejtuar MASR kërkesa për riorganizimin e programit të studimit përmes shkresës me Nr. 99/1 prot, datë 29.09.2017, ka patur një zhvillim të rëndësishëm në kuadrin ligjor që rregullon profesionin e psikologut në Republikën e Shqipërisë.





Në 26 maj 2016, me hyrjen në fuqi të ligjit “Për urdhrin e psikologut në Republikën e Shqipërisë”, Nr. 40/2016, në nenin 7 të tij “Kriteret e anëtarësisë”, në pikën 2 “Anëtarët e Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:”, në nënpikën b të tij, përcaktohet se personat duhet “b) të kenë diplomën e studimeve të larta “Bachelor” dhe “Master shkencor” ose “Master profesional” në psikologji ose ekuivalent me të, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, brenda apo jashtë vendit, të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin”.

Ky kuadër i ri ligjor, përcakton se personi i interesuar për t’u licensuar si psikolog, do të duhet të ketë përfunduar studimet në fushën e psikologjisë. Të pyetur lidhur me veprimet që Departamenti i Shkencave të Edukimit kishte ndërmarrë për t’u siguruar se programi i ofruar prej tyre ofronte një diplomë e cila ishte në përputhje me përcaktimet e ardhura nga ky kuadër i ri ligjor dhe rregullues i profesionit të psikologut, Drejtuesi i Departamentit, GVB dhe stafi akademik cilësuan se të vetmet ndryshime që ishin përcjellë në MASR ishin ato që kishin të bënin me ndryshimet që përcaktonte Urdhri i akreditimit.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e programit të studimit “Bachelor në Psikologji Këshillimi dhe pedagogji”

Programi i studimit Bachelor në Psikologji këshillimi dhe pedagogji ka pranuar brezin e parë të studentëve në vitin akademik 2012- 2013. Qëllimi kryesor i programit është “edukimi dhe zgjerimi i njohurive rreth fushave të studimit (psikologji dhe pedagogji) të mbështetur në etikën profesionale, përgatitja e studentëve në hartimin e kujdesshëm të raporteve dhe të analizimit të problematikave të ndryshme të individëve si dhe dhënia e një kulture të gjerë pluraliste në mënyrën e mendimit dhe konceptimit të problemeve në fushën e edukimit dhe psikologjisë.

Sa i takon objektivave specifike të programit të studimit, ato lidhen me përgatitjen e studentit me dije dhe aftësi në drejtime të ndryshme të psikologjisë, duke përfshirë fusha të tilla si: zhvillimi njerëzor; psikologjia sociale; këshillimin psikologjik, si dhe formimin e tyre të përgjithshëm në fusha të tilla si: njohuri bazë për kërkimin shkencor; formim të përgjithshëm qytetar, etj.

Edhe pse nuk është paraqitur në këtë pikë të RVB, pas shqyrtimit të vetë programit mësimor, grupi i lëndëve me drejtim pedagogjinë përmbushin formimin e studentit në fusha të tilla si: njohuri për gjuhën shqipe; drejtshkrim, etj. Programi, duke qenë një ndërthurje e psikologjisë dhe pedagogjisë, ka si objektiv formimin e përgjithshëm të studentëve në të dyja këto fusha.

- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 32 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 16 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë në auditor
- 1 orë mësimore = 60’/50’ (në vitin akademik 2018-2019, bazuar në urdhrin e MASR, ora mësimore u bë 50 minuta).

- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë.

Sipas paraqitjes në tabelë, për çdo vit akademik, semestri parashikon marrjen e 60 ECTS.

Në vitin e parë akademik, parashikohen 640 orë studimi në auditor dhe 860 orë studimi punë e pavarur, gjithsej 1500 orë.

Në vitin e dytë akademik, parashikohen 640 orë studimi në auditor dhe 860 orë studimi punë e pavarur, gjithsej 1500 orë.





Në vitin e tretë akademik, parashikohen 640 orë studimi në auditor dhe 860 orë studimi punë e pavarur, gjithsej 1500 orë.

*Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 27 në RVB, gjendet në Aneksë në Tabelën 15.*

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

1 kredit (ECTS) është përlogaritur në këtë mënyrë, për të tre vitet akademik në total:

▪ Për leksionet	1920 orë në auditor	dhe	2580 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Seminaret	192 orë në auditor	dhe	108 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për laboratorët	0 orë në auditor	dhe	0 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Praktikat lëndore	0 orë në auditor	dhe	0 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Praktikën Profesionale	48 orë në auditor	dhe	77 orë punë e pavarur e studentit
▪ Provimi përfundimtar	48 orë në auditor	dhe	784 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të

Ashtu sikurse u paraqit edhe në pjesën hyrëse të kësaj pike të RVJ, KUB nuk ka bërë asnjë ndryshim në programin mësimor në vitet 2013 – 2018. Aktualisht, edhe pas hyrjes në fuqi të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, programi mësimor vazhdon të jetë i pandryshuar nga programi fillestar. Të vetmet ndryshime që i janë bërë, për të përmbushur rekomandimet e Vendimit të Akreditimit, kanë qenë shtimi i lëndëve të profilit të pedagogjisë në grupin e lëndëve me zgjidhje. Por ky ndryshim nuk ka sjellë ndryshime në numrin total të krediteve dhe orëve mësimore në total, për cdo semestër. Edhe ndarja e lëndëve sipas veprimtarive paraqitet nga A në F (Shiko Aneksë, tabela 16) dhe jo sipas VKM nr 41, dt 24.01.2018, ku kjo ndarje duhet të jetë nga A në E sipas veprimtarive të përcaktuara në të.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Ashtu sikurse janë paraqitur edhe në tabelën nr. 29 në RVB, mbulimi i realizimit të planeve mësimore me personelin akademik, është si më poshtë:

Viti akademik 2013-2014: 24 lëndë mbulohen nga PAE dhe 12 lëndë nga PAK.

Viti akademik 2014-2015: 22 lëndë mbulohen nga PAE dhe 14 lëndë nga PAK

Viti akademik 2015-2016: 28 lëndë mbulohen nga PAE dhe 8 lëndë nga PAK

Viti akademik 2016-2017: 35 lëndë mbulohen nga PAE dhe 1 lëndë nga PAK

Viti akademik 2017-2018: 32 lëndë mbulohen nga PAE dhe 4 lëndë nga PAK

Ngarkesa mësimore në tre vitet e fundit aademike mbulohet kryesisht nga PAE (edhe pse ka pedagogë që mbulojnë më shumë se dy lëndë) mbi masën 70% sipas përcaktimeve ligjore. Duhet theksuar se kryesisht, lëndët mbulohen nga staf akademik i departamenteve të tjera. **Gjithashtu duhet theksuar se, sikurse paraqitet në RVB, ashtu edhe nga biseda me GVB dhe anëtarët e stafit akademik, vetëm një pedagoge (MSc. E. A) është e diplomuar në Bachelor dhe Master i Shkencave në Psikologji. Pjesa tjetër e stafit të brendshëm janë të profilit të pedagogjisë ose me profil miks, pedagogji dhe psikologji.**

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Vlerësimi i sulabuseve është bërë duke marrë në konsideratë faktin se sulabuset nuk janë përshtatur sipas shtojcës Nr. 2 të VKM Nr 41, datë 24.01.2018. Syllabuset kanë një përmbajtje e cila siguron një informim të plotë të studentëve lidhur me lëndën përkatëse, detyrimet dhe literaturën përkatës. Për më shumë detaje, cdo sulabus përmban pjesët e mëposhtme:

○ Emërtimin e lëndës/modulit



- Vitin/semestrin kur zhvillohet lënda
- Emrin e pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesën në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Ashtu sikurse është paraqitur në RVB dhe e konfirmuar nga takimet me përfaqësuesit e departamentit, në çdo fillim viti njësia bazë organizon ëorkshop-e dhe takime për të diskutuar lidhur me cilësinë e sulabuseve dhe nevojën për ndryshim.

Ashtu sikurse paraqitet edhe në modelin e sulabusit në RVB (*Shiko Anekse, tabela 17*), studenti njihet në fillim të semestrit me secilën nga lëndët. Duhet theksuar se, duke qenë se gjuha në të cilën zhvillohet programi i studimit Bachelor në Psikologji këshillimi dhe pedagogji, studentët duhet të jenë njohës të gjuhës angleze. Ashtu sikurse u theksua në të gjitha takimet në institucion, studentët regjistrohen pasi kanë vërtetuar nivelin e tyre të gjuhës angleze. Në rastet kur ky nivel nuk është i përshtatshëm, KUB iu krijon mundësinë e ndjekjes së kurseve ndihmëse për të arritur nivelin e duhur të gjuhës.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA</b>	
<b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Ashtu sikurse është paraqitur në RVB si dhe të mbështetur në shkëmbimin e informacionit në të gjitha takimet në vizitën e GVJ në institucion, u arrit në përfundimin se programi i studimit Bachelor në Psikologji këshillimi dhe pedagogji është ofruar pasi ka marrë vendimin e akreditimit me Urdhër Nr. 223, datë 04.06.2013.</p> <p>Ky program studimi ka një organizim të brendshëm konform kuadrit ligjor përkatës, përmes organizimit në vite akademik, të ndarë secili në 60 ECTS.</p>
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit;</p>	<p>Departamenti i Shkencave të Edukimit jep një informacion të plotë sa i takon informacioneve të duhura lidhur me përmbajtjen e programit Bachelor në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji.</p> <p>Departamenti i Shkencave të Edukimit është shumë i hapur dhe përgjegjës për organizimin e programit në terma të lëndëve të detyrueshme dhe lëndëve me zgjedhje për cdo semestër.</p> <p>Departamenti i Shkencave të Edukimit jep në mënyrë të plotë informacion të detajuar mbi ngarkesën mësimore</p>



**Kriteri 4** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.

dhe realizimin e saj, mbi orët në auditor dhe orët e punës individuale, realizimin e frekuentimit të programit të studimit, etj.

Departamenti i Shkencave të Edukimit ka dhënë informacion të detajuar lidhur me sullabuset e secilës lëndë, praktikat mësimore, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

Programi i studimit Bachelor në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji është hartuar në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimet e Kolegjit Universitar Bedër. Organizimi i moduleve dhe vlerësimi i tyre me kredite është bërë në zbatim dhe në përputhje të plotë me Sistemin Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Në këtë kontekst, në përfundim të çdo viti akademik, student parashikohet të grumbullojë 60 (ECTS). Departamenti zotëron plotësisht njohuritë dhe aftësitë për të administruar programin e studimit Bachelor në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji. Konstatohet se aktualisht programi i studimit Bachelor në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji nuk është organizuar në përputhje me përcaktimet e bëra në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".

## **8. Mësimdhënia**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia është një element shumë i rëndësishëm për KUB. Ashtu sikurse paraqitet në RVB, por edhe të deklaruar nga vetë stafi akademik si dhe e konfirmuar nga studentët, mësimdhënia është në harmoni të plotë me qëllimin për ta bërë studentin shumë aktiv dhe të përfshirë në procesin mësimor. Mësimdhënia realizohet përmes bashkërendimit të disa formave, duke përfshirë: leksionet, seminarët, projektet personale, në çift ose në grup, punët kërkimore përmes përpunimit të literaturës ose kërkimeve në terren, etj.

Stafi akademik i Departamentit të Shkencave të Edukimit është i hapur për bashkëpunime me profesionistë të fushave, duke i bërë ata pjesë integrale të procesit akademik përmes leksioneve të hapura, ndjekjes së aktiviteteve specifike në terren, etj.

Kontrolli i njohurive të studentëve bëhet në harmoni të plotë me nivelin e vazhdueshëm të angazhimit të tyre duke përfshirë: testimet e ndërmjetme; punët kërkimore me literaturën ose në terren; detyra të ndryshme kursi; projekte semestrale; prezantime individuale ose në grup; vlerësim për pjesëmarrjen aktive të studentëve përgjatë procesit mësimor në leksione dhe/ose në seminare; etj.

Ashtu sikurse theksohet në RVB, dhe konfirmohet nga stafi akademik dhe vetë studentët, mësimdhënia mbështetet nga teknologji informacioni, tabela interaktive (Smart Bord-e), kompiutera, projektorë, etj. Gjithashtu, për mësimdhënien e lëndëve të caktuara, të tilla si statistika dhe gjuhësia. KUB e lehtëson procesin e mësimdhënies përmes ndjekjes së leksioneve, seminareve dhe veprimtarive të tjera akademike me laboratorë përkatës.

Vlen për t'u theksuar se vlerësimi i metodave të mësimdhënies është një ndër dimensionet e vlerësimit të kryer me studentët për secilin pedagog dhe lëndë përkatëse. Në vijim të rezultateve të marra nga përpunimi i përgjigjeve nga anketimi i studentëve, departamentet marrin masat e nevojshme për përmirësimin e mëtejshëm të këtyre metodave. Këshilli i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i mbështetur nga Zyra e Burimeve Njerëzore, për të realizuar edhe përmirësimin e këtyre metodave, organizon trajnime të stafit akademik në fusha të caktuara ku paraqitet nevoja. Këto trajnime publikohen në faqen zyrtare të NJSBC. Ashtu sikurse përshkruhet në RVB dhe e konfirmuar nga takimi me personelin e Këshillit të Sigurimit të



Cilësisë, së fundmi në KUB është ngritur Komisioni i Përhershëm për garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit.

Një tjetër masë e marrë për të rritur vëmendjen ndaj rëndësisë së mësimdhënies si dhe për të mbështetur personelin akademik në drejtim të patjes së më shumë hapësirave për zhvillim profesional në drejtim të mësimdhënies, në çdo njësi bazë është punësuar një personë administrativ, i cili angazhohet me detyrat administrative të cilat më parë i bënte stafi akademik.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (Ploteso Tabela e Planit ne aneks):

Mësimdhënia realizohet përmes ndërthurjes së disa formave të saj, duke synuar realizmin e njohjes së studentëve me njohuritë dhe aftësitë bazë që ofron programi i studimit, por edhe për të realizuar rritjen e angazhimit të drejtpërdrejtë të studentit në procesin e mësimdhënies. Ky program mësimor nuk ka të parashikuar orë laboratorike, ushtrime dhe praktikë lëndore.

Programi i Studimit Master Profesional në Psikologji Klinike		
Format e mësimdhënies		Orët totale në auditor
a.	Leksione	1920
b.	Seminare	E integruar
c.	Ushtrime	-
d.	Laboratore	-
e.	Praktikë lëndore	-
f.	Praktikë profesionale	48
g.	Provimi përfundimtar	48
	Në total	2016

- Format e kontrollit të njohurive

Ashtu sikurse paraqitet edhe në RVB dhe u konfirmuar në të gjitha takimet me stafin akademik, punonjës të zyrave mbështetëse në KUB dhe vetë studentët, vlerësimi i dijeve bëhet nga disa drejtime. Përgjithësisht, pavarësisht specifikave të secilës lëndë dhe vendimit të secilit pedagog për format më të përshtatshme të vlerësimit të njohurive, ky vlerësim përfshin:

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive	p.sh. 10%
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	p.sh 10%



Testimet gjatë vitit	p.sh 20%
Provimi përfundimtar	60%
Etj	
Në total	100%

Studentët njihen me format e vlerësimit në fillim të çdo lënde.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Ashtu sikurse është paraqitur edhe në pikën 10, Kërkimi shkencor në funksion të programit të studimit, KUB duke përfshirë edhe aktivizimin e drejtpërdrejtë të Departamentit të Shkencave të Edukimit, ka një fokus të veçantë në drejtim të aktivitete kërkimore dhe shkencore që organizon, si për nevoja të vetë institucionit, ashtu edhe në bashkëpunim me aktorë të tjerë të zhvillimit akademik dhe jo vetëm, si në nivel kombëtar ashtu edhe atë rajonal dhe ndërkombëtar.

Aktivizimi i drejtpërdrejtë i studentëve është një ndër prioritetet e punës së gjithë anëtarëve të stafit akademik. Ashtu sikurse paraqitet në tabelë, studentët janë angazhuar në organizimin dhe pjesëmarrjen në disa aktivitete.

Aktiviteti shkencor i IAL	Numri i studentëve të aktivizuar
Për punime shkencore individuale të pedagogëve	7
Për projekte shkencore në rang Departamenti	60
Për punime shkencore në rang Fakulteti	120
Për punime shkencore në bashkëpunim me të tjerë	5

## 9. Studentët

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Mbwshtetur në RVB, GVJ konstaton se pranimi i studentëve në programin e studimit Bachelor në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji është bërë në respektim të ligjit për Arsimin e Lartë, në dy periudha kohore. Deri në vitin 2015 pranimet/regjistrimet janë bërë sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".

Studentët pajisen me një adresë elektronike, e cila jo vetëm i bën të ndjehen pjesë e KUB, por iu lehtëson edhe komunikimin dhe shpërndarjen e informacionit përgjatë gjithë viteve të studimit. Studentët informohen në kohë reale përmes sistemit BIS, i cili ka rritur shumë transparencën dhe kontrollin nga vetë studentët.

Pas plotësimit të dosjes me dokumentacionin përkatës, ajo vendoset në Sekretarinë Mësimore. Nga verifikimi i bërë pranë Sekretarisë Mësimore, dosja e një student në programin Bachelor në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji përmbante:

- Formular me të dhënat personale
- Dokument performance
- Kontrata
- Deklarata e te dhenave
- Diplome e Maturës Shtetërore
- Certifikatë e Maturës Shtetërore



- Fotokopje ID

Duke qenë se programi i studimit zhvillohet në gjuhën angleze, personat e interesuar, përveç përmbushjes së kriterëve të tjera ligjore, duhet të paraqesin edhe dëshminë e mbrojtjes së gjuhës angleze. Përgjithësisht ata vijnë pasi kanë mbrojtur gjuhën angleze përmes provimit APTIS, një provim që administrohet nga Këshilli Britanik në mjediset e KUB. Për të gjithë studentët që nuk arrijnë të kenë nivelin e përshtatshëm të gjuhës angleze, KUB ofron kurse pa pagesë për të ndihmuar studentët të arrijnë nivelin e duhur të gjuhës së huaj.

Në momentin e regjistrimit në KUB, të interesuarit priten nga zyra e Pranimit e cila iu siguron studentëve edhe informacionet e para lidhur me KUB dhe vetë programin e studimit. Studentët përcillen te Këshilltarët Akademikë, të cilët do të shërbejnë si persona kyç për orientimin e studentëve përgjatë të tre viteve të studimit në programin e studimit Bachelor në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji. Përveç Këshilltarit Akademik, studentët ndihmohen në drejtim të planifikimit dhe fuqizimit të karrierës së tyre përmes Këshilltarëve të karrierës, të cilët ofrohen përmes Zyrës së Planifikimit të karrierës, e cila funksionon pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me studentët. Kjo zyrë ofron programe të veçanta mbështetëse për studentët, të tilla si orientimi për përgatitjen e CV-së, apo prezantimin në publik apo kërkimin e punës. Zyra e Alumnit i mbështet gjithashtu studentët përmes organizimit të takimeve informale me Alumni të profilit përkatës, duke mundësuar që, përmes ndarjes së përvojës së tyre të shkollimit dhe të punësimiti, të shërbejnë si udhërrëfyes për studentët e rinj.

Studentët janë të përfaqësuar në disa nivele dhe organizma brenda KUB, si në: Senatin Akademik; Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe në Komisione të tjera të përhershme.

Ashtu sikurse paraqitet edhe në RVB, deklarohet nga stafi akademik dhe konfirmohet nga vetë studentët, studentët mbahen vazhdimisht të informuar lidhur me të gjitha zhvillimet që ndodhin në KUB, përmes njoftimeve verbale, afishimeve në tabelat përkatëse dhe njoftimeve përmes sistemit BIS ose në faqen zyrtare në internet.

#### **Vlerësimi i Tregues të matshëm:**

- Procedurat e pranimit të studentëve

Ashtu sikurse përmbahet në RVB dhe konfirmohet nga stafi akademik dhe vetë studentët, pranimi i studentëve ndjek të gjitha përcaktimet ligjore dhe rregulloret e institucionit. Personeli akademik deklaron se, përgjithësisht, grupet janë të vogla duke e mbajtur raportin pedagog/student në masën 1/8.03.

RVB përcakton se janë disa kriteret specifike të pranimit të studentëve. Për vitin akademik 2018-2019 këto kriteret përfshinin:

1. Mesatarja e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, në masën 70%;
2. Intervista nga Komisioni i vlerësimit, i formuar nga departamenti përkatës, në masën 30%;
3. Plotësimi i kushtit të mjaftueshmërisë së gjuhës së huaj, në nivelin B1. Studentët mund të dorëzojnë një certifikatë të njohjes së gjuhës.

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Cilësia në hyrje të studentëve ndër vitet akademik 2013-2018 varion nga 7.02 (në vitin 2013) në 8.51 (në vitin 2016). Ndërkohë vihet re një tendencë për të ruajtur të njëjtën ecuri edhe në mesataret dalje të studentëve në përfundim të programit të studimit.

- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare.

Ashtu sikurse është paraqitur në RVB, në tabelën 33, janë paraqitur në formë të përmbledhur të dhënat sa i takon mesatareve hyrëse të studentëve të regjistruar në vitet akademike 2013-2018. (*Shiko Anekse, tabela 18*)

- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare



Numri total i studentëve të diplomuar në vitin 2018 ishte 8.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Studentët mund të transferojnë studimet e tyre në KUB përmes procedurave të qarta të transferimit, pasi të bëhet barasvlerësi i provimeve sipas planeve mësimore përkatëse. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student, i takon strukturës mësimore që pranon studentin, në këtë rast Departamentit të Shkencave të Edukimit, bazuar mbi plotësimin e dy kriterëve:

- Ngjashmërinë e programit të studimit (të atij që ka kryer në universitetin e mëparshëm me programin mësimor Bachelor në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji);
- Kohën e kryerjes së studimeve.

Për miratimin e transferimit të studimeve, pasi janë zbatuar afatet kohore të përcaktuara nga MASR, Këshilli i Departamentit kryen të gjitha procedurat e ekuivalentimit dhe miraton regjistrimin e studentit në vitin përkatës. Gjithsesi, KUB ka edhe një kriter tjetër përcaktues për lejimin e transferimit të studimeve dhe regjistrimit në KUB: studenti duhet të kryejë në KUB të paktën dy semestra.

Në RVB si dhe në takimet me anëtarët e stafit akademik, numri i të punësuarve të diplomuar në Bachelor në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji është rreth 50%. Gjithsesi, për faktin se programi i studimit që po vlerësohet është program Bachelor dhe, pas përcaktimeve ligjore të bëra me hyrjen në fuqi të ligjit “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, duhet mbajtur në vëmendje se nuk mund të punësohen si psikologë personat që nuk kanë përmbyllur studimet e tyre në Bachelor dhe Master në Psikologji, të cilët do të duhet gjithashtu të kryejnë edhe një praktikë profesionale dhe provimin e licensës.

Në këtë kontekst, punësimi i studentëve të cilët kanë përfunduar vetëm studimet Bachelor në Psikologji do të binte ndesh me ligjin.

Ashtu sikurse u deklarua nga stafi akademik dhe vetë studentët, studentët pas diplomimit janë punësuar kryesisht pranë institucioneve arsimore me të cilat KUB është partnere.

Numri total të diplomuarve

Ashtu sikurse është paraqitur në RVB, e konfirmuar nga të dhënat prej takimeve në vizitën në institucion, si dhe në dokumentacionin e verifikuar në Sekretarinë Mësimore, numri total i studentëve të diplomuar në vitet akademike 2013-2018 është 58 studentë në total. Në vitin akademik 2018-2019 janë regjistruar 17 studentë për herë të parë. (Shiko Aneksë, Tabela 19 dhe tabela 20)

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</b>	
<b>Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi. <b>Kriteri 2</b> Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Pranimi i studentëve është bërë në përputhje të plotë me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi si dhe në përputhje të plotë me Ligjin aktual të Arsimit të Lartë 80/2015 KUB ka përcaktuar kriteret e qarta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore. Kandidatët njihen me këto kriteret, ndër të cilët është edhe provimi i gjuhës angleze, pasi mësimi në këtë program studimi zhvillohet në këtë gjuhë.
<b>Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.</b>	



<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Në momentin e regjistrimit, gjatë javës së Orientimit si dhe përgjatë kontakteve me Këshilltarin Akademik përgjatë gjithë tre viteve të studimit, studentët informohen lidhur me të gjitha detajet lidhur me Programin e studimit Bachelor në Psikologji këshillimi dhe pedagogji, duke përfshirë: organizimin e programit të studimit; kohëzgjatjen e programit, etj.</p> <p>Në mënyrë të përvitshme, studentët vlerësojnë secilin nga pedagogët përmes anketave konfidenciale.</p> <p>Zyra e Planifikimit të Karrierës iu ofron studentëve një shërbim të vazhdueshëm lidhur me mundësitë e punësimit të tyre në të ardhmen si dhe lidhur me aftësi të tjera mbështetëse për të cilat ata do të kenë nevojë për t'iu qasur në mënyrën më të mirë të mundshme tregut të punës.</p> <p><u>Studentët nuk janë të informuar për pengesat që do të hasin në licensimin e tyre si psikologë, pas hyrjes në fuqi të ligjit “Për Urdhrin e Psikologut në republikën e Shqipërisë”.</u></p> <p><u>Thuajse të gjithë studentët e pyetur nga GVJ në takim me ta lidhur me punësimin e tyre në të ardhmen, ata pohuan se do të punësoheshin si psikologë ose si mësues. Të dy këta janë profesione të rregulluara, të cilët kërkojnë një diplomë të profilizuar në secilën prej fushave.</u></p>
<p><b>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, kryesisht në Sekretarinë mësimore por edhe në takimet e ndryshme të realizuar gjatë dy ditëve, GVJ konstatoi se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- KUB disponon statistika të plota lidhur me numrin e të diplomuarve për çdo vit akademik për ciklin e parë të studimit.</li> <li>- KUB disponon të dhëna të plota lidhur me dinamikën e regjistrimeve, transferimeve dhe ç’regjistrimeve në çdo vit të programit të studimit, për të gjitha vitet akademike.</li> <li>- KUB disponon të dhëna të plota lidhur me ecurinë akademike të secilit student përgjatë të treja viteve të studimit në programin Psikologji këshillimi dhe pedagogji.</li> </ul>
<p><b>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Institucioni përmes këshilltarit akademik, personeli akademik përgjegjës, arrin të sigurojë mbarëvajtjen e ecurisë dhe trajtimin e problematikave të ndryshme që mund të hasin studentët përgjatë procesit akademik.</p> <p>Zyra e planifikimit të karrierës lehtëson përcjelljen e studentëve në institucione në të cilat do të mund të zhvillojnë praktikën profesionale. Kjo realizohet përgjithësisht ose në institucionet partnere, ose në institucione në të cilat punojnë studentë ALUMNI të departamenteve përkatëse.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p>	
<p>Studentët e regjistruar në programin e studimit Bachelor në “Psikologji këshillimi dhe pedagogji” regjistrohen në KUB pasi përmbushin kriteret e përcaktuara në ligj dhe pasi përmbushin kriterin e njohjes së gjuhës së huaj.</p> <p>Studentët e diplomuar vetëm në nivelin Bachelor në Psikologji këshillimi dhe pedagogji nuk mund të punësohen vetëm pas diplomimit në këtë nivel studimi (kuadri ligjor kërkon përfundimin e studimeve edhe në nivelin e dytë). Gjithashtu studentët nuk janë të informuar për faktin se profili miks i programit të studimit Bachelor në Psikologji këshillimi dhe pedagogji nuk do t’ua mundësojë licensimin si psikolog dhe punësimin</p>	



në këtë profesion. Gjithashtu, profile miks i programit të studimit, përbën një pengesë edhe për të fituar të drejtën e punësimit si mësues, në zbatim të përcaktimeve ligjore për profesionet e rregulluara. Mendojmë se KUB dhe veçanërisht Departamenti i Shkencave të Edukimit duhet të rishikojë programin e studimit dhe të konsiderojë riorganizimin e programit, me qëllim sigurimin e licensimit të mëvonshëm të studentëve në profesionin në të cilin do të duan të punësohen, si psikologë ose si mësues.

## **KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.**

### **10. Kërkimi shkencor**

#### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Kërkimi shkencor në Kolegjin Universitar Bedër është në vëmendjen e veçantë të Zyrës së Kërkimit Shkencor. KUB- i nxit dhe i mbështet vazhdimisht anëtarët e stafit akademik për të zhvilluar kërkime shkencore përmes alokimit të një fondi vjetor prej 700 Euro përmes të cilave të mund të realizojnë projektet kërkimore. Gjithashtu ky institucion ofron mbështetje financiare për pjesëmarrjen e secilit anëtar të stafit në një aktivitet kërkimor brenda ose jashtë vendit të paktën një herë në vit.

Në secilin vit akademik 2013-2018, Departamenti i Shkencave të Edukimit ka realizuar botime në Revistën me bord editorial Bedër Journal of Educational Sciences (BJES). Githashtu, për çdo vit akademik 2013-2016 ky department ka zhvilluar nga një ëorkshop ndërkombëtar, përkatësisht:

Në vitin akademik 2013-2014 është zhvilluar ëorkshop-i me temë “Perspektiva e shërbimit psiko-social në institucionet arsimore në Shqipëri”;

Në vitin akademik 2014-2015 është zhvilluar ëorkshop-i me temë “Institucionet arsimore ndërkombëtare në Shqipëri, një vlerë e shtuar për arsimin shqiptar”;

Në vitin akademik 2015-2016 është zhvilluar workshop-i me temë “Perspektiva të zhvillimit të kurrikulave në programet e formimit për mësues dhe roli i arsimit të lartë”.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Ashtu sikurse paraqitet edhe në tabelën përkatëse (*Anekse, tabela 21*), në KUB 2012-2018 janë zhvilluar në mënyrë të përvitshme konferenca ndërkombëtare.

Në mënyrë të veçantë, në kuadër të punës së vetë Departamentit të Shkencave të Edukimit, në vitet akademike 2013-2018 janë realizuar seminare me fokus fushat e psikologjisë dhe pedagogjisë, si më poshtë vijon:

Viti akademik 2013-2014: 1 seminar

Viti akademik 2014-2015: 2 seminare

Viti akademik 2015-2016: 6 seminare

Viti akademik 2016-2017: 8 seminare

Viti akademik 2017-2018: 6 seminare

Referuar të dhënave në RVB por edhe gjatë takimeve të GVJ kryesisht me stafin e programit por edhe me GVB, na u komunikua se janë një sërë aktivitetesh në vitet e fundit, të planifikuara, individuale dhe në rang programi ku stafi akademik ka marrë pjesë. (*Shiko Anekse, tabela 22*). Këto aktivitete përfshijnë: Botimet e ndryshme nga stafi efektiv i Kolegjit; aktivitetet shkencore të organizuara nga Kolegji për programin e studimit; përfshirje në kërkimin shkencor edhe të studentët edhe pse programi është i ciklit të parë Bsc; etj.

### **11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun**



## Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Kolegji Universitar Bedër, prej viti 2012 ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me 56 institucione, ndër të cilat pjesa më e madhe prej tyre janë institucione të arsimit të lartë, bashki, institucione publike dhe private. (Aneks, tabela 24)

Marrëveshtet e bashkëpunimit synojnë të realizojnë disa qëllime:

- Plotësimin e nevojave për praktikë profesionale të studentëve për programe dhe nivele të ndryshme studimit;
- Realizimin e konferencave të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare me interes të ndërsjelltë;
- Realizimin e trajnimeve të ndërsjellta midis stafëve të dy institucioneve, etj

Ashtu sikurse përcaktohet në RVB por edhe siç na u komunikua edhe në vizitën në institucion, në vitet 2012-2018, KUB ka realizuar rreth 26 konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare në bashkëpunim me institucione si brenda edhe jashtë vendit. Në takimin me drejtuesen e Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare u cilësua se numri më i madh i marrëveshjeve të bashkëpunimit është realizuar në periudhën 2012-2015. Ndërkohë që vitet e fundit ka ndryshuar trendi i marrëveshjeve të realizuara, përmes realizimit të marrëveshjeve me programin Erasmus + dhe mundësinë për të firmosur marrëveshje shkëmbimi me dy universitet kineze. Ndër vite, anëtarë të stafit të KUB kanë përfituar nga mobiliteti duke patur mundësinë të angazhohen në mësimdhënie në periudha të caktuara në vende të ndryshme të botës.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (Shiko Aneks, tabela 23)

Ashtu si është paraqitur në RVB dhe sikurse na u komunikua nga përfaqësuesja e Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare, në kuadër të pjesëmarrjes së stafit akademik dhe të studentëve të programit të studimit Bachelor në Psikologji këshillimi dhe pedagogji në aktivitete të bashkëpunimit ndërkombëtar, treguesit janë paraqitur në tabelën 40 të RVB (Aneks, tabela 23), sipas të cilit:

- Studentët që kanë përfituar nga mobiliteti janë 6;
- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë KUB dhe prezantime janë 7.

Ashtu sikurse u qartësua edhe në pikën 10 të RVJ, KUB mbështet vazhdimisht stafin akademik për pjesëmarrje në aktivitete të natyrës kërkimore shkencore edhe në mbështetje të bashkëpunimit ndërkombëtar.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (plotëso të dhenat në aneks)

Ashtu sikurse është paraqitur edhe në tabelën 41 të RVB (Aneks, tabela 24), KUB ka aktive 43 marrëveshje me universitete ndërkombëtare, 8 marrëveshje me institucione/organizata profesionale publike dhe private si dhe 2 marrëveshje me komunitetin e biznesit. Këto marrëveshje firmosen kryesisht për një periudhë 4-5 vjeçare dhe, në kushte të mungesës së kërkesës për rishikim të kushteve, kontrata cilësohet si e rinovuar edhe për një periudhë tjetër po aq vjeçare.

### Vlerësimi sipas Standardeve



Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</b>	
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Institucioni nxit dhe mbështet stafin akademik të shkëmbejë informacion për të rritur cilësinë e programit të studimit përmes rregullimit të komunikimit elektronik me pajisjen me adresë të dedikuar për secilin anëtar, me ngritjen e grupeve/komisionëve për çështje të caktuara, etj.</p> <p>Vazhdimisht dhe në mënyrë periodike Institucioni realizon vlerësime të ndryshme lidhur me cilësinë e punës së secilit sektor dhe bashkëpunimit midis sektorëve. Ky proces i vazhdueshëm mbikëqyrjeje dhe vlerësimi shërben si një mjet për të garantuar bashkëpunimin e frytshëm midis sektorëve.</p>
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të programit të studimit Bachelor në Psikologji këshillimi dhe pedagogji institucioni ka realizuar marrëveshje me institucionet homologe për të rritur kapacitetin e stafit akademik si dhe për të nxitur përmirësimin e vetë programit përmes ndarjes së përvojës.</p> <p>Institucioni ka bërë të mundur që, përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit, të lehtësojë realizimin e praktikës profesionale të përcaktuar në këtë program studimi, duke lehtësuar atashimin e studentëve në organizata dhe/ose institucione në të cilat ata mund të njoihen nga afër me rolin e psikologut dhe mësuesit.</p> <p>Një ndër funksionet e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të tjera është edhe rritja e kapaciteteve në mënyrë të ndërsjellit e stafeve të të dyja institucioneve partenere.</p> <p>Institucioni në përfundim të çdo marrëveshjeje si dhe në momente të tjera kur ndërmerr vendime për zhvillime në fusha të caktuara, bën një analizë të ecurisë dhe suksesit të arritur përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit, duke konsideruar rishikimin e marrëveshjes, rinovimin ose mbylljen e saj.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<p>Departamenti i Shkencave të Edukimit, në harmoni me orientimin ndërkombëtar të vetë Kolegjit Universitar Bedër, është i hapur për të vendosur marrëveshje bashkëpunimi me institucione partnere si kombëtare edhe ndërkombëtare. Përmes këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit, Departamenti i Shkencave të Edukimit synon të rrisë kapacitetin e anëtarëve të stafit akademik; të krijojë mundësinë për të përmirësuar vetë programet e studimit. Numri i marrëveshjeve është i konsiderueshëm dhe më kalimin e viteve është rritur jo vetëm në sasi, por edhe në terma të përzgjedhjes gjithnjë e më shumë të partnerëve të cilët i shërbejnë zhvillimit strategjik të Kolegjit Universitar Bedër.</p>	

## ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

### **I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË**

KUB ka plotësuar kryesisht rekomandimet e dhëna nga KA në vendimin për akreditimin e parë.



## II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

### Pikat e forta

- Një nivel i lartë i përfshirjes së drejtpërdrejtë të studentëve në Kolegjin Universitar "Bedër";
- Bibliotekë shumë e pasur, si në tituj të fushave të Psikologjisë dhe Pedagogjisë, ashtu edhe në shërbimet e tjera që ofrohen në bibliotekë, në shërbim të orientimit të studentëve;
- Një rrjet shumë i madh i institucioneve, sidomos në fushën e edukimit, në të cilat studentët mund të zhvillojnë praktikën profesionale.
- Një historik i pasur i kërkimit shkencor dhe konferencave shkencore ndër vite.

### Pikat e dobta

- Numri i ulët i stafit akademik në fushën e Psikologjisë;
- Mungesë e përditësimit të programit të studimit me kuadrin ligjor që rregullon profesionet e psikologut dhe mësuesit;
- Vështirësi në rekrutimin e studentëve për shkak të zhvillimit të mësimin në gjuhën angleze dhe pasigurisë së studentëve shqiptarë për të studiuar në këtë gjuhë.

### Mundësitë


- Rrjetëzimi me institucione të tjera të edukimit parauniversitar lehtësojnë prurjet e studentëve dhe garantojnë cilësinë e tyre;
- Rrjetëzimi me universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit lehtëson rritjen e kapaciteteve të stafit;
- Zhvillimi i mësimin në gjuhën angleze mundëson trajtimin e literaturës më bashkëkohore në gjuhë të huaj (pasi ka mungesa të vazhdueshme të teksteve në gjuhën shqipe në fushën e Psikologjisë dhe Pedagogjisë);
- Zhvillimi i mësimin në gjuhën angleze mund të lehtësojë rekrutimin e personelit akademik të huaj, në kushte të mungesës së personelit akademik me grada shkencore në Shqipëri.

### Kërcënimet

- Mospërputhja e programit të studimit me kuadrin ligjor të profesioneve të rregulluara të psikologut dhe mësuesit mund të sjellë pengesa në licensimin e studentëve të diplomuar, duke kërcënuar vazhdimësinë e këtij programi studimi;
- Rënia e nivelit të zotërimit të gjuhës angleze me kalimin e viteve e vështirëson ecurinë e programit që ofrohet në gjuhën angleze.

### Rekomandime:

1. Të shikojë mundësinë e përthithjes së pedagogëve me formim në fushën e psikologjisë.
2. Departamenti i Shkencave të Edukimit duhet të rishikojë programin e studimit dhe të konsiderojë riorganizimin e programit, me qëllim sigurimin e licensimit të mëvonshëm të studentëve në profesionin në të cilin do të duan të punësohen, si psikologë ose si mësues dhe në vijim përshtatja me përcaktimet e bëra në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".
3. Të konsiderohet mundësia për ta ofruar programin e studimit në gjuhën shqipe.





## SWOT analyses for "Bachelor in Counseling Psychology and Pedagogy" study programme

### Strengths

- A considerable high level of students direct engagement in "Bedër University College";
- A very rich library, with scientific titles in Psychology and Pedagogy fields, as well as in terms of other student oriented services offered in the library;
- A broad network of institutions, especially in the education area, that students can develop their professional practice.
- A rich background of scientific research and conferences.

### Weaknesses

- Low number of academic personel qualified in Psychology;
- Lack of updating the study program in compliance with legal framework that regulates both psychologist and teaching professions;
- Difficulties in students' recruiting due to the fact that English is the program language, and Albanian students feel insecurities to study in this language.

### Possibilities

- The network with other pre-university education institutions might increase the number of potential students for this programme, as well as can guarantee the quality of the recruited ones;
- The network with other universities, inside and outside Abania, facilitates staff capacity building;
- English as the programme language enables the use of foreign adequate literature (there has always been a lack of adequate scientific literature in Albanian, especially in fields such as Psychology and Pedagogy);
- English as programe language can facilitate the recruiting process of international academic staff, due to lack of Albanian academic personel with adequate credentials.

### Threats

- Discordance between the study programme and the legal framework of regulated professions of both Psychologist and Teachers, can create obstacles in the licensing process of students that have a degree in this programe, threatening, as such, the continuity of the programme itself;
- The decrease of the level of English fluency through high school students puts this programme in difficulties.

### Reccomandations:

1. Evaluating the possibility to recruite academic personel qualified in Psychology.
2. The Departament of Educational Sciences should review the study programe considering the reorganization of the programe aiming to facilitate the future licencing process of students in any one of the professions that that ming want to have; other psychologist or teacher. Further more, the Department should consider reorganizing the programme to get inlined with the legal framework deriving from VKM Nr. 41, date 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".
3. Considering the possibility of offering this study programme in Albanian language.


Grupi i Vlerësimit të Jashtëm



**External Evaluation Group**

1. Dr Marjana Çadri

2. Dr Silvana Loka

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'S. Loka', is written over the text of the second member of the External Evaluation Group.